VIOLETA SHAMKU

MUZIKA

LIBËR MËSUESI

Klasa II

BOTIME

pegi

BOTIME

Redaktore letrare: Erina ÇOKU
Paraqitja grafike: Elidor KRUJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9928-228-04-8

© Botime Pegi, gusht 2016
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

1. Hyrje
   1.1 Pse shërben ky libër?
   1.2 Çfarë synon ky libër?
   1.3 Çfarë përmban ky libër?

2. **Kompetencat** dhe kuptimi i tyre
   2.1. Lidhja e muzikës me *kompetencat kyçe*
   2.2. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare
   2.3. Kuptimi i *kompetencave lëndore muzikore*, i *tematikave* dhe lidhja ndërmjet tyre.

3. **Planifikimi i kurrikulës –** kuptimi dhe zbatimi
   3.1. Plani vjetor i lëndës "Muzikë"
   3.2. Plani tremujor (i ndërthurur)

4. **Metodologjia e të nxënit dhe e mësimdhënies** bazuar në kompetenca në lëndën e muzikës
   4.1. Situata e të nxënit
   4.2. Planifikimi ditor

5. Vlerësimi
   5.1. Llojet e vlerësimit në klasën e parë/ shkallën e parë (arsimi fillor).

1. Hyrje

I dashur koleg!

Muzika është një disiplinë artistike e artit dhe gjuhë universale që i ndihmon nxënësit/et t'i kuptojnë dhe t'i lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre, si dhe duke shpjeguar mënyrat e interpretimit dhe të ndërtimit të tyre, gjë e cila çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimit të muzikës. Nxënësi/ja tashmë e ka filluar rrugëtimin e tij në muzikë përmes njohjes me dy elementet bazë ***ritmin*** dhe ***melodinë***. Ritmin e kanë zbuluar dhe gjetur në mjedisin përreth dhe më pas në muzikë, kanë përjetuar duke provuar modele të ndryshme ritmike dhe kanë krijuar ritme me dy, tri dhe katër goditje. Tingujt i kanë zbuluar në mjedisin përreth dhe kanë filluar të përcaktojnë dhe karakteristikat e tyre duke u shprehur me fjalë të thjeshta.

Ndërsa këngët dhe lojërat didaktike për fëmijë, apo dhe këngët-lojë popullore, të përshtatshme për nga karakteri, përmbajtja e shtrirja e vokalit (zërit), me dhe pa shoqërim instrumental, mësohen duke formuar kështu një kulturë vokale, përmes ***teknikave*** të kënduarit dhe ***procesit*** të këndimit. Luajtja me instrumentet me goditje dhe shoqërimi i këngëve dhe i lojërave muzikore është një tjetër veprimtari që njohin dhe kryejnë nxënësit/et. Krijimi i modeleve ritmike përmes ligjërimit të vargjeve, shoqërimit me lëvizje trupore, me shuplaka, janë veprimtari që zhvillohen në këtë nivel moshe dhe intelekti të fëmijëve.

Lënda e muzikës synon të edukojë dhe formojë nxënësit nga pikëpamja muzikore, duke i orientuar ata me krijimtari drejt kuptimit të veçorive të ligjërimit muzikor nga më e thjeshta te më e ndërlikuara përmes gjuhës dhe komunikimit muzikor, drejt marrjes pjesë dhe interpretimit në veprimtaritë muzikore individuale dhe në grup përmes teknikave dhe procesit muzikor, drejt formimit dhe krijimit të një vlerësimi dhe qëndrimi artistik në njohjen me veprat muzikore.

Ndaj zhvillimi i muzikës në shkollë është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimine personalitetit të nxënësve/eve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur e sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

Pse shërben ky libër?

Ky libër do t'ju shërbejë mësuesve/eve të muzikës, si një ***udhërrëfyes*** ku ata/ato do të demonstrojnë aftësitë e tyre edukuese dhe profesionale në lëndën e muzikës, për zbatimin më së miri të risive dhe të qasjes së re të kurrikulës me kompetenca.

Çfarë synon ky libër?

Mësimdhënia bazuar në ***kompetenca***, e trajtuar përmes këtij libri do të shërbejë si për të gjithë mësuesit/et e muzikës, të ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë e arsimit fillor, programet mësimore* dhe të vlerësimit bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave në klasën e dytë,* të cilat përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

a) planifikimin e të nxënit;

b) metodologjinë e mësimdhënies;

c) vlerësimin e të nxënit bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe të ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e dytë, për të përmbushur synimet e kurrikulës së muzikës, për ndërtimin e kompetencave lëndore atdhe atyre kyçe, për të planifikuar dhe për të realizuar detyrat e tyre si mësimdhënës/e të kësaj lënde, në përshtatje me dokumentet zyrtare dhe fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së dytë, të shkallës së parë të lëndës *Muzikë*, miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014 dhe merr përsipër:

- ***të sqarojë*** të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit, që duhet të zbatojë çdo mësues/e që jep mësim në klasën e dytë;
- **të paraqesë *dokumentet*** e hartuara dhe ***mënyrën se si ato*** duhet të përdoren nga mësuesi/ja në lëndën e muzikës;
- të udhëzojë ***formatet*** e reja: plani vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, formatet e vlerësimit etj., me të cilat mësuesi/ja duhet të punojë gjatë një viti shkollor.

Ndryshe nga çka mësuesi/ja është mësuar të gjejë në një libër mësuesi, ky libër jep në parim dhe ofron ose sugjeron modele , por ***nuk i dikton*** ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënit dhe metodologjinë apo vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

AUTORJA

1. PROGRAMI MËSIMOR, KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Programi mësimor zhvillon përmbajtje të caktuara mësimore/muzikore që i përgjigjen moshës dhe nivelit intelektual të nxënësve/eve të kësaj klase dhe qëllimit që ka lënda në shkollat publike. Gjithashtu ky program krijon kushte për ndërtimin e ***kompetencave të lëndës*** së ***muzikës*** si dhe të ***kompetencave kyçe***, të cilat ndërthuren me njëra tjetrën; realizimin e ***temave ndërkurrikulare*** apo ***lidhjes së muzikës me fushat e tjera kurrikulare,*** të cilat janë gjithashtu komponentë të rëndësishëm për kontributin e muzikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë edukimit dhe formimit të nxënësve/eve.

Muzika e klasës së dytë bën pjesë në ***shkallën e parë:*** parashkollori (mosha 5-6 vjeçare – klasa dytë).

1.1. Kompetencat kyçe dhe muzika

Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit;
2. kompetenca e të menduarit;
3. kompetenca e të mësuarit për të nxënë;
4. kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin;
5. kompetenca personale;
6. kompetenca qytetare;
7. kompetenca digjitale.

Diagrami 1: Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës, për shkallën e parë

SHKALLA E PARË
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Nxënësi/ja: • aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike; • kupton simbolet muzikore që i shfaqen; • Shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve muzikore. • Komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë.
Kompetenca e të menduarit
Nxënësi/ja: • mendon në mënyrë krijuese; • merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese; • zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese; • kupton ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Nxënësi/ja: • përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor; • përdor burime e gatshme për të realizuar një krijim muzikor; • zbaton detyrën e dhënë.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
Nxënësi/ja: • bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës.
Kompetenca personale
Nxënësi/ja: • zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore; • respekton punën e vet dhe të të tjerëve; • bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave.
Kompetenca qytetare
Nxënësi/ja: • diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
Kompetenca digjitale
Nxënësi/ja: • njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

1.2. Kompetencat dhe tematikat në lëndën e muzikës:

a) *kompetencat lëndore muzikore*;

b) *tematikat* që përfaqësojnë përmbajtjen muzikore përgjatë klasës së dytë.

Qasja e bazuar në kompetenca është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në çdo fushë të nxëni në gjithë arsimin fillor. Ato zhvillohen dhe ndërtohen përmes kompetencave të **krijimit, të interpretimit dhe të vlerësimit**. Këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së muzikës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre. Kompetencat lëndore të muzikës lidhen dhe plotësojnë dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike **kompetencat kyçe.**

Zotërimi i muzikës nënkupton ***zotërimin e kompetencave muzikore***, që do të thotë aftësia për të krijuar, për të interpretuar një këngë apo lojë muzikore dhe për të vlerësuar duke gjykuar dhe duke përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata në të cilat muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.

Me kurrikulën e re, muzika është strukturuar me tri (3) kompetenca, të cilat renditen si më poshtë:

Kompetenca 1: Krijimi muzikor

Nxënësit/et krijojnë kompetencën për përdorimin e ideve të ndryshme në organizimin e krijimit muzikor, për përdorimin e elementeve muzikore gjatë krijimit, për zhvillimin e ideve të reja gjatë krijimit dhe për organizimin e krijimit sipas strukturës muzikore, duke ndarë përvojat e veta krijuese me të tjerët.

Kompetenca 2: Interpretimi muzikor

Nxënësit/et krijojnë kompetencën për kuptimin dhe zbatimin e teknikave të këndimit,apo të luajtjes në instrument, të interpretimit dhe të improvizimit deri në përsosjen e saj. Respektimin e rregullave të luajtjes në instrument dhe ndarjen e përvojave të veta interpretuese me të tjerë.

Kompetenca 3: Vlerësimi muzikor

nxënësit/et krijojnë kompetencën për kuptimin dhe analizimin e veprave muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

Tabela 1: Kompetencat lëndore dhe përshkrimi i tyre

Kompetencat lëndore	Përshkrimi i kompetencave
Krijimi muzikor	Nxënësi/ja: - përdor ide të ndryshme, duke përdorur elementet dhe gjuhën muzikore; - eksperimenton duke zbuluar dhe duke zhvilluar më tej idetë e veta artistike; - organizon krijimin e vet muzikor, sipas elementeve të gjuhës muzikore; - ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.
Interpretimi muzikor	Nxënësi/ja: - familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave të ndryshme muzikore (këngë/lojëra muzikore, fragmente muzikore); - njeh dhe zbaton teknika dhe procese të ndryshme muzikore gjatë këndimit dhe luajtjes me instrumente; - respekton rregullat e interpretimit muzikor gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente; - ndan përvojat e veta interpretuese me të tjerë.
Vlerësimi i veprave muzikore	Nxënësi/ja: - shpjegon me fjalor të thjeshtë këngë/lojëra dhe vepra muzikore të thjeshta.

Tematikat që përshkojnë lëndën e muzikës

TEMATIKAT E MUZIKËS	KOMPETENCAT E MUZIKËS
Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi muzikor	Kompetenca 1: Krijimi muzikor Kompetenca 2: Interpretimi muzikor Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave muzikore
Tematika 2:Teknika dhe procese muzikore	
Tematika 3: Historia, muzika dhe shoqëria	

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e muzikës synon të përmbushë *3 kompetencat e lëndës* që arrihen nëpërmjet *3 tematikave*.

Tematikat *përmbajtjesore,* janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit dhe krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet* dhe *vlerat*, në funksion të *kompetencave të lëndës* dhe *të kompetencave kyçe*. Për çdo tematikë janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të çdo shkalle përkatëse. Përshkrimi i secilës **tematikë** dhe i **kompetencave lëndore** që duhet të demonstrojë nxënësi/ja lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle.

Diagrami: Kompetencat *kyçe dhe lëndore,* që formohen përmes *tematikave të muzikës.*



Nëse do të bënim një shpjegim të diagramit, vërejmë se *kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së muzikës, ku në qendër të mësimdhënies (procesit) është nxënësi/ja. Mësuesi/ja duhet të ketë parasysh kompetencat lëndore dhe çfarë rezultatesh

2.4. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare - diagrami

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj si me: kërcimin, artin pamor, teatrin, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul, si me: matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore etj. Kështu mësuesit duhet t'u japin mundësinë

nxënësve/eve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të muzikës me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.

2. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es që zgjat përgjatë gjithë vitit shkollor dhe që shoqërohet me përgatitjen e dokumenteve përkatëse.

Koha mësimore sipas tematikave për secilën klasë

Lënda e muzikës zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë në arsimin fillor.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

Tematikat	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknika dhe procese	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa e dytë	**8**	**22**	**5**	**35 orë**

Planifikimi i dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi kërkon: *liri, elasticitet* dhe *përgjegjshmëri në planifikim*. Këto dokumente janë:

plani vjetor i lëndës së muzikës;

plani tremujor (i ndërthur sipas tematikave).

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar me tremujorë, ku secili tremujor ka një grup të caktuar orësh, në bazë të periudhës kohore të përcaktuar në udhëzimin e çdo fillim të vitit të ri shkollor . Pra, kemi tashmë një term të ri *tremujor* dhe jo *semestër.*

Për shkak të specifikës që ka, lënda e muzikës duhet t'i ndërthurë tematikat dhe njohuritë me njëra-tjetrën, për të mos e bërë monotone orën mësimore dhe lëndën përgjatë:

a) planifikimit vjetor të tremujorëve;

b) planifikimit vjetor temë për temë.

Tremujorët në modelet e mëposhtme janë ndarë, duke bërë një përllogaritje të përafërt të zgjatjes së shkollës përgjatë këtyre periudhave *me* + *ose* – që çdo mësues i llogarit vetë.

PLANIFIKIMI VJETOR I LËNDËS MUZIKË, SIPAS TEMATIKAVE DHE TREMUJORËVE

Tematika	**Shpërndarja e përmbajtjes lëndore**		
	Shtator – Dhjetor 12 orë	**Janar – Mars 12 orë**	**Prill - Qershor 11 orë**
Gjuha dhe komunikimi muzikor (8 orë)	1. Ritmi dhe burimi i tij	1. Tempi: shpejtësia *ngadalë-shpejt*	1. Tingulli *i lartë – i ulët, i fortë – i butë*
	2. Ritmi me dy goditje	2. Tingujt e rregullt dhe të parregullt (zhurmat)	2. Tingulli *i gjatë – i shkurtër*
	3. Theksi muzikor *(i fortë – i butë).*	3. Vetitë e tingujve	
Teknika dhe procese muzikore (22 orë)	4. Rregullat e këndimit	4. Këngë lojë:"Gjuha e kafshëve"	3. Luajmë me instrumente me goditje
		5. Luajmë me instrumente me goditje Rituali popullor: Rona rona peperona	4. Rituale popullore
			5. Shoqërojmë ritualet e mësuara me mjete trupore
	5. Kënga: "Himni flamurit"	6. "Kënga: "Ëndrra"	
			6. Kënga "Tren, o tren"
		7. Kënga: "Festa e mësuesit"	
			7. Kënga-lojë: "Simfonia e kafshëve"
	6. Kënga: "Mjeshtri i vogël"	8. Shoqërojmë këngën me mjete trupore	
			8. Kënga: "Unë dhe kominoshet"
		9. Kënga: "Fjalët magjike na pëlqejnë"	9. Rikujtojmë këngët e mësuara
	7. Ndërtojmë instrumente me goditje : t*amburi/ zilka/trekëndëshi/ shkopinjtë*		
	8. Kënga: "Dua më shumë Shqipërinë"		
	9. Këngë-lojë popullore: Huhu baba hu (recitim dhe mbajtje ritmi)		
Historia, muzika dhe shoqëria (5 orë)	10. Muzika dhe përjetimi i saj	10. Shprehim emocionet për muzikën përmes arteve të tjera	10. Muzika për fëmijë
	11. Muzika dhe filmi për fëmijë: "Tomka dhe shokët e tij" dhe filma të huaj	11. Muzika dhe nxënësit/ et	
	12. Koncert	12. Koncert	11. Koncert
Gjithsej	**35 orë**		

PLANIFIKIMI TREMUJOR[1], LËNDA MUZIKË, PERIUDHA: SHTATOR – DHJETOR

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Nxënësi/ja:
1. aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike;
2. kupton simbolet muzikore që i shfaqen;
3. shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve muzikore;
4. komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë.

Kompetenca e të menduarit
Nxënësi/ja:
1. mendon në mënyrë krijuese;
2. merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese;
3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese;
4. kupton ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Nxënësi/ja:
1. përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor;
2. përdor burime e gatshme për të realizuar një krijim muzikor;
3. zbaton detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
Nxënësi/ja:
1. bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës.

Kompetenca personale
Nxënësi/ja:
1. zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore;
2. respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
3. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave.

Kompetenca qytetare
Nxënësi/ja:
1. diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.

Kompetenca digjitale
Nxënësi/ja:
1. njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

[1] Bazuar në specifikën që ka kjo lëndë në ndërthurjen e tematikave, përshkrimi i tyre dhe i kompetencave lëndore mund të bëhet më vete, por gjithmonë i bazuar vetëm në tërësinë e njohurive që do t'u jepen nxënësve/eve për çdo tremujor.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor	***Interpretimi muzikor***	***Vlerësimi muzikor***
Nxënësi/ja: • kërkon dhe zbulon shumëllojshmëri burimesh ritmike dhe melodike (tingullore); • imiton dhe demonstron kuptimin e karakteristikave të tingujve muzikorë ose jo muzikorë; • improvizon modele të ndryshme ritmike ose jo ritmike; • demonstron zbatimin e elementeve të gjuhës muzikore, gjatë krijimeve të ndryshme; • komunikon njohuritë rreth gjuhës muzikore; • provon të improvizojë mbi një këngë apo melodi ritmin dhe karakterin duke përdorur elemente të tjera si trupin.	Nxënësi/ja: • interpreton gjatë këndimit, këngë dhe lojëra për fëmijë; • demonstron gjatë luajtjes me mjetet trupore apo instrumentet fëmijërore me goditje se ka kuptuar elementet e ritmit dhe të melodisë; • këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; • interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës; • interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; • interpreton lojërat muzikore duke ndihmuar në inskenimin e tyre; • respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; • respekton këngë të kulturave të tjera; • komunikon mendimin e vet rreth këngës apo lojës muzikore; • reflekton emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo pjesë muzikore gjatë interpretimit.	Nxënësi/ja: • shpreh qartë emocionet e veta ndaj muzikës; • jep mendimin e vet gjatë shpjegimit emocional të këngës, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë muzikore; • fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë muzikor për t'u shprehur në mënyrë artistike; • shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet e veta muzikore; • shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon; • përdor elementet e gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional; • përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; • bën lidhje ndërmjet asaj që përjeton dhe asaj që dëgjon nga një këngë, lojë muzikore apo fragment muzikor; • shpreh mendimin e vet rreth këngës/pjesës që dëgjon; • merr pjesë në veprimtari të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës; • përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar punën e vet dhe të të tjerëve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

NR.	TEMATIKA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT	BURIME DHE MATERIALE
1	*Teknika dhe procese*	Kënga: "Himni i Flamurit"	**Situata: Udhëtim imagjinar në vendlindjen time** Nxënësit/et nxiten të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata/ato bëjnë një udhëtim imagjinar duke përdorur mjete të tilla shprehëse, si: fjalën, vizatimin, tregimin etj.	- CD me këngën; - foto të ndryshme; – teksti i mësuesit.
2	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Ritmi dhe burimet e tij	**Situata: Një ditë te lodrat** Nxënësit/et nxiten të përfytyrojnë një ditë në lodrat e qytetit dhe të zbulojnë pikërisht ato lodra që krijojnë dy goditje: treni *çaf-çuf,* shilarësi *fiu- fiu,* kërcimi mbi dyshekun sustë *lart – poshtë etj*. Ata kuptojnë se goditjet e lodrave janë të ndryshme dhe ndonjëherë jo ritmike pra, të çrregullta. Vendosen disa fragmente ku nxënësit/et duhet të ritme të ndryshme të krijuara nga burime apo objekte të ndryshme.	- CD me shembuj; - foto të ndryshme; - teksti i mësuesit.
3	*Historia, muzika dhe shoqëria*	Muzika dhe përjetimi i saj	**Situata: Muzika ime e parapëlqyer** Vendosen disa fragmente muzikore në magnetofon 1-2 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë muzikë të llojeve të ndryshme (klasike, këngë për fëmijë, popullore, moderne, vals).	- CD; - foto të ndryshme; - teksti i mësuesit.

			Ata/ato përcaktojnë muzikën që u pëlqen më shumë dhe shprehen pse e pëlqejnë atë.	
4	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Ritmi me dy goditje	**Situata: Numërojmë 1-2** Vendosen disa fragmente muzikore në magnetofon, 1-2 minuta ku nxënësit/et dëgjojnë burime të ndryshme me dy goditje: zemra, pulsi, çekiçi, ora etj. Ata/ato i numërojnë dhe tregojnë burime të tjera të ritmit me dy goditje nga muzika apo jeta e përditshme duke kuptuar që këto goditje janë ndryshme.	- CD; - foto të ndryshme; - teksti i mësuesit.
5	*Teknika dhe procese*	Kënga: "Mjeshtri i vogël"	**Situata: Profesionet** Mësuesi/ja tregon disa fotografi profesionesh të ndryshme, të cilat nxënësit/et i gjejnë dhe i përshkruajnë ato. Më pas ata/ato nxiten të flasin për profesionin që parapëlqejnë të bëjnë në të ardhmen.	- CD; magnetofon; - foto; - teksti i mësuesit.
6	*Teknika dhe procese*	Ndërtojmë instrumente me goditje: *tamburi/zilka/ trekëndësh/ shkopinj*	**Situata: Instrumenti im i parapëlqyer** Vendosen në tavolinë disa materiale, të cilat janë grupuara veç e veç. Në krah vendoset një foto e instrumentit që duhet të ndërtohet me këto materiale. Nxënësit/et udhëzohen se çfarë rruge duhet të ndjekin për ta ndërtuar atë.	- foto të instrumentit; - materiale të ndryshme; - teksti i mësuesit.

7	*Historia, muzika dhe shoqëria*	Muzika dhe filmi për fëmijë	**Situata: Kuic me muzikë filmash** Dëgjohen fragmente të shkurtra muzikore nga filma shqiptarë dhe filma të ndryshëm për fëmijë. Grupet e ndara gjejnë nëpërmjet dëgjimit të muzikës emrin e filmit. Nxënësit/et nxiten të flasin pse u pëlqen filmi dhe nëse muzika e zbukuron atë.	- CD; - foto të ndryshme; - teksti i mësuesit.
8	*Teknika dhe procese*	Ritual popullor: Huhu baba hu	**Situata: Loja e fjalëve** Nxënësit/et recitojnë këngën-lojë në shpejtësi të ndryshme, duke theksuar rrokjen (goditjen më të gjatë). Ata/ato gjatë mësimit të tekstit kuptojnë rëndësinë e theksit të fjalës dhe të goditjes. Teksti i këngës-lojë përsëritet disa herë.	- CD ; - instrumente me goditje (*tamburi/ zilka/trekëndëshi/ shkopinj);* - teksti i mësuesit.
9	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Theksi muzikor me dy goditje	**Situata: Konkurs** Zhvillohet kuici: *kush gjen fjalë me dy rrokje*. Fjalët me dy rrokje shkruhen në dërrasë. Grupi që gjen më shumë fiton konkursin. Më pas nxënësit/et i lexojnë sërish fjalët për të gjetur se në cilën rrokje zëri forcohet më shumë. Ai është theksi i fortë.	- CD; - foto të ndryshme; - teksti i mësuesit.
10	*Teknika dhe procese*	Kënga: “Dua më shumë Shqipërinë ”	**Situata: Qyteti im** Nxënësit/et marrin në dorë një fletë me emrin e qytetit, për të cilin dëshirojnë të flasin. Kur mësuesi/ja ose një nxënës/e thërret emrin e qytetit ata/ato thonë disa karakteristika që dinë për të.	- CD; - foto të ndryshme; - teksti i mësuesit.

11	*Teknika dhe procese*	Koncert		
12	*Teknika dhe procese*	Koncert		

PLANIFIKIMI DITOR PËR TREMUJORIN Ë PARË – SHTATOR – DHJETOR

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** "Këngë:" Himni i Flamurit"		**Situata: Udhëtim imagjinar në vendlindjen time** Nxënësit/et nxiten që të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata/ato bëjnë një udhëtim imagjinar duke përdorur forma të ndryshme të shprehjes emocionale: fjalën, vizatimin, tregimin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon këngën me ndjenjë dhe emocion; - shpreh emocionet e veta për këngën himn; - përjeton dhe shpjegon muzikën , duke përdorur një fjalor të thjeshtë.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit; - kënga himn.	
Burimet: - kënga në CD; - teksti i mësuesit; - foto ose materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia, gjuha shqipe dhe edukim për shoqërinë. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** - identiteti im.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një bisedë me nxënësit/et, të cilët/at nxiten që të shprehin emocionet që ndiejnë kur flasin për vendlindjen e tyre. Ata/ato bëjnë një udhëtim imagjinar duke u shprehur nëpërmjet fjalës, vizatimit, tregimit. Ata/ato kujtojnë se çfarë është kënga himn dhe thonë si duhet ta këndojnë atë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Dëgjohet kënga dhe më pas vijohet me mësimin e saj. Nxënësit/et e këndojnë atë, me vargje, pastaj me strofë, duke e përsëritur të gjithën disa herë deri në interpretimin shumë mirë të saj. Ata/ato: - këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion; - diskutojnë me njëri tjetrin rreth këngës himn, Shqipërisë dhe qyteteve që pëlqejnë etj.; - këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion.			

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (Shqipëria, kënga himn etj.).
- këndimin me emocion të këngës;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga "Himni i flamurit" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.



Himni i flamurit

Teksti: Asdreni
Muzika: Çirio Porumbesku

- I -

Rreth flamurit të përbashkuar
Me një dëshir' me një qëllim,
Të gjith' atij duk' iu betuar
Të lidhim besën për shpëtim.
Prej lufte veç ay largohet
Që është lindur tradhëtor,
Kush është burrë nuk frikohet,
Por vdes, por vdes si një dëshmor!

- II -

Në dorë armët do t'i mbajmë
Të mbrojmë atdhenë më çdo kënd,
Të drejtat tona ne s'i ndajmë,
Këtu armiqtë s'kanë vend.
Se Zoti vet e tha me gojë
Që kombe shuhen përmbi dhe,
Po Shqipëria do të rrojë,
Për të, për të luftojmë ne!

- III -

O flamur, flamur, shenj` e shenjtë,
Te ty betohemi këtu,
Për Shqipërin` atdhen` e shtrenjtë,
Për nder` edhe lavdimn` e tu.
Trim, burrë quhet dhe nderohet
Atdheut kush iu bë theror;
Për jet` ay do të kujtohet
Mbi dhe, nën dhe si një shenjtor!

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Gjuha dhe komunikimi muzikor* **Tema mësimore:** Ritmi dhe burimet e tij		**Situata: Një ditë te lodrat** Nxënësit/et nxiten të përfytyrojnë një ditë në këndin e lojërave dhe të kujtojnë lodrat që krijojnë dy goditje, si: treni *çaf-çuf,* shilarësi *fiu-fiu,* kërcimi mbi dyshekun sustë *lart-poshtë etj.* Ata/ato kuptojnë se goditjet e lodrave janë të ndryshme dhe ndonjëherë jo ritmike, pra të çrregullta. Ata/ato dëgjojnë ritme të ndryshme të krijuara nga burime apo objekte të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kërkon dhe zbulon burime ritmike që krijohen dhe dëgjon në mjedisin përreth; - identifikon dhe imiton shumëllojshmëri burimesh ritmike; - improvizon modele të ndryshme ritmike ose jo ritmike.		**Fjalët kyçe:** - ritëm; - dy goditje/rrahje; - burim ritmesh.	
Burimet: - CD me burime të ndryshme ritmike (troku i kalit trak-trok, kuakjen e bretkosës kuak-kuak, mjaullimën e maces mjau-mjau etj.); - mjete që krijojnë ritëm; - foto të parapërgatitura nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - matematika: matematika. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** - mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve - Mësimi fillon me një situatë ku nxënësit/et tregojnë ose përfytyrojnë një ditë këndin e lojërave dhe kujtojnë pikërisht ato lodra që krijojnë dy goditje, si: treni *çaf-çuf,* shilarësi *fiu-fiu,* kërcimi mbi dyshekun sustë *lart – poshtë etj.* Ata/ato kuptojnë se goditjet e lodrave janë të ndryshme dhe ndonjëherë jo ritmike, pra të çrregullta. Në magnetofon luhen ritme të ndryshme të krijuara nga burime apo objekte të ndryshme. Nxënësit/et dëgjojnë dhe i identifikojnë këto ritme që krijohen nga burime të ndryshme, nga vetë ata/ato etj., si: goditja e çekiçit çak-çak; ritmi i akrepave të orës tik-tak etj.			
Ndërtimi i njohurive të reja - Mësuesi/ja fillon mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të dëgjojnë me vëmendje ritme të ndryshme në CD dhe të identifikojnë objektet prej të cilave krijohen ato. Nxënësit/et përjetojnë dhe krijojnë ritme të ndryshme, përmes rrahjeve të shuplakave, të këmbëve apo të mjeteve ose veglave të ndryshme si shkopinj, tambur etj. Më pas diskutojnë me			

njëri-tjetrin rreth burimit dhe objekteve/instrumenteve që krijojnë ritmet që dëgjohen në magnetofon, por që mund të dëgjohen edhe në mjedisin e klasës apo jashtë tij. Ata/ato krijojnë ritme apo modele ritmike të ndryshme, sipas dëshirës dhe imitojnë me *objekte të ndryshme, me shuplaka apo me zë* ritmet që njohin, vetëm ose në grup.

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (ritmin);
- përcaktimin e ritmeve të ndryshme që dëgjon në mjedisin ku ndodhet apo CD;
- krijimin dhe bashkëveprimin në grup për realizimin e ritmeve të ndryshme, sipas dëshirës, duke i shpjeguar ato.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Informacion për mësuesin

Ritëm pa muzikë ka, ndërsa muzikë pa ritëm NUK KA. Ritmi dhe tingujt përbëjnë atë që quhet muzikë. Ritmi ngacmon gjallërisht veshin tonë. Atë e ndeshim në natyrë, në jetën e përditshme, në mjedisin ku jetojmë apo mësojmë. Ritmi gjendet kudo në hapin tonë, në rrahjet e zemrës, në tiktakun e orës, në fshirëset e xhamave të makinave etj. Ritmin fillojmë ta ndiejmë sapo lindim te lëkundjet e djepit, tek e folura etj. Loja muzikore ka brenda saj ritmin, i cili, duke bashkëngjitur gjallërinë dhe gëzimin e tij bëhet shumë i dashur për fëmijët. Refreni i kësaj kënge është një shembull didaktik shumë i mirë për të kuptuar ritmin.

Veprimtari praktike muzikore

Hapi I

Pyetje: Sa goditje ka kënga?

Përgjigje: Nxënësit thonë: “dy” dhe rrahin dorën, duke ligjëruar: “1-2”.

Gjatë këndimit me nxënësit realizoni karakterin e saj të gëzueshëm.

Hapi II

Nxënësit/et vëzhgojnë dhe shkruajnë emrin përkatës poshtë çdo figure që krijon dy lëvizje ose jep dy goditje.

1 – 2 (poshtë – lart)

_____ _____ _____



_____ _____ _____ _____

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika dhe përjetimi i saj		**Situata: Muzika ime e parapëlqyer** Dëgjohen në magnetofon për 1-2 minuta disa fragmente muzikore të llojeve të ndryshme (klasike, këngë për fëmijë, popullore, moderne, vals). Nxënësit/et përcaktojnë muzikën që u pëlqen më shumë dhe shprehen *pse e pëlqejnë atë.*	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon pjesë të ndryshme muzikore: *këngë për fëmijë, valse, këngë moderne* dhe edukohet me përqendrimin në dëgjim; - identifikon karakteristika dhe ndryshime të pjesëve që dëgjon, i dallon dhe i gjen ato; - reflekton emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo pjesë muzikore gjatë dëgjimit të saj, duke dhënë gjykimin e vet pse i pëlqen.		**Fjalët kyçe:** - muzika; - parapëlqim; - përjetim emocional.	
Burimet: - CD me shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - artet: arti pamor dhe kërcimi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me një veprimtari ku për 1-2 minuta dëgjohen në magnetofon disa fragmente muzikore të llojeve të ndryshme (klasike, këngë për fëmijë, popullore, modern, vals). Nxënësit/et përcaktojnë muzikën që u pëlqen më shumë dhe shprehen pse *e pëlqejnë atë?*

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja zhvillon më tej situatën e krijuar, duke bërë ndalesa për secilin fragment muzikor që dëgjojnë nxënësit/et. Kjo formë pune me nxënësit/et bën që ata/ato të identifikojnë lloje të ndryshme muzikore dhe të shprehin emocionet që u krijohen prej tyre. Nxënësit/et jo vetëm shprehen rreth muzikës që dëgjojnë, por edhe mundohen të identifikojnë :

- llojin e zërave që dëgjojnë;
- instrumentet që dëgjojnë;
- shpejtësinë e muzikës që luhet;
- ndjesinë që u krijohet;
- arsyen pse e pëlqejnë atë etj.

Ata/ato dëgjojnë me vëmendje fragmente të ndryshme dhe bëjnë dallimin midis llojeve të ndryshme muzikore (popullore, këngë për fëmijë, vals etj). Më pas dallojnë karakteristikat e muzikës që dëgjojnë dhe shprehin emocionet që ndiejnë ose u krijon ajo, në klasë në familje, në komunitet apo nëpërmjet arteve të tjera, si: vizatim, kërcim, poezi.

Nxënësit/et flasin duke argumentuar në mënyrë të thjeshtë rreth muzikës që dëgjojnë. Në përfundim ata/ato kanë filluar të krijojnë një mënyrë gjykimi rreth muzikës që dëgjojnë, duke mësuar të shprehin emocionet e tyre.
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/et do të bëhet për *rezultatet e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën dhe përjetimin që merr prej saj; - dallimin e llojeve të ndryshme muzikore; - qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth muzikës me fjalë të thjeshta dhe duke shpjeguar pse e pëlqen atë.
Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

VEPRIMTARI PËRMES ARTEVE TË TJERA

Hapi I

✓ *Nxitini nxënësit/et të rrethojnë apo të ngjyrosin, sipas përjetimit emocional nga dëgjimi i pjesëve muzikore të vendosura në CD.*

Hapi II

✓ *Nxitini ata/ato të shprehen me fjalë të thjeshta për muzikën që dëgjojnë, emocionet që iu ngjall ajo dhe arsyen pse e pëlqejnë ose jo.*



Kjo muzikë është e bukur, sepse...

_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Kjo muzikë është e mërzitshme, sepse...

_____
_____
_____
_____
_____
_____

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Gjuha dhe komunikimi muzikor* **Tema mësimore:** Ritmi me dy goditje		**Situata: Numërojmë 1 - 2** Nxënësit/et dëgjojnë në magnetofon disa fragmente nga burime të ndryshme ritmike me dy goditje: *zemra, pulsi, çekiçi, ora* etj. Ata/ato numërojnë dhe tregojnë burime të tjera të ritmit me dy goditje nga ritme muzikore apo jeta e përditshme duke kuptuar që këto goditje janë të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - identifikon shumëllojshmëri burimesh ritmike (kryesisht me dy goditje); - demonstron kuptimin e ritmit me dy goditje; - krijon modele të thjeshta me dy goditje përmes simboleve grafike.		**Fjalët kyçe:** - ritëm; - ritëm me dy goditje; - simbol grafik.	
Burimet: - CD me shembuj ritmikë të përgatitur nga mësuesi/ja; - ushtrime me modele ritmike; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat natyrore: matematika. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** - mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me gjetjen e disa burimeve që krijojnë ritëm ose me dëgjimin në magnetofon të disa fragmenteve nga burime të ndryshme ritmike me dy goditje: *zemra, pulsi, çekiçi, ora* etj. Nxënësit/et numërojnë dhe tregojnë burime të tjera të ritmit me dy goditje nga muzika apo jeta e përditshme duke kuptuar që këto goditje janë të ndryshme.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja më pas kërkon që një nxënësit/et të kujtojnë tekstin e këngës-lojë ”Çova një letër mu në postë”. Në vijim ata/ato e shkruajnë atë nëpërmjet simboleve grafike (forma e zemrës, pika uji etj.). dhe më pas e luajnë sipas simboleve që kanë shkruar. Nxënësit/et e korrigjojnë këngën dhe e përsërisin, duke shoqëruar me shuplaka. Nxënësit/et: - dëgjojnë me vëmendje fragmente të ndryshme ritmike dhe i dallojnë ato; - bëjnë dallimin midis llojeve të ndryshme ritmike: me dy , tri dhe katër goditje; - sjellin modele të ndryshme ritmike që dinë apo kanë dëgjuar më parë; - regjistrojnë përmes simboleve grafike tekstin e këngës-lojë; - shoqërojnë me shuplaka regjistrimin grafik të krijuar. Regjistrimi grafik i këngës ruhet në dosjen e nxënësit/es.			

Vlerësimi
- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: ritmi me dy goditje;
- bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për regjistrimin grafik të ritmit me simbole;
- shoqërimin e tekstit me shuplaka dhe të regjistrimit grafik të krijuar vetëm ose në grup.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Zhvillimi i veprimtarise

Hapi I

❖ *recitojnë dhe shoqërojnë me shuplaka këngën-lojë "Çova një letër mu në postë";*

Hapi II

❖ *paraqesin tekstin e këngës-lojë me simbole të tjera të personalizuara (trekëndësh ose shkopinj) sipas goditjeve që ajo ka.*



Recitativi
Aj baj komisar,
nia, mia kompania,
se meraku tiki – taku,
aj baj buf.

Rona – rona peperuna,
bjerë shi në arat tona,
të na rritet bereqeti,
le të hajë gjith'mileti.

Me melodi
Çova një letër mu në post'.
tuj shku rrugës m'humbi,
erdhi shoqja mbrapa meje,
dhe në xhep ma vuri.

Angalupi la, la, la, la
Angalupi la, la, la, la.

Hapi III

❖ *Pas çdo figure nxënësi/ja plotëson me rrokje gjuhën e secilës kafshë, duke e provuar edhe me vegla me goditjet e gjata dhe të shkurtra.*

Rezultati i veprimtarise:
✓ *ritmin përmes goditjeve;*
✓ *ritmin përmes fjalëve dhe rrokjeve;*
✓ *ritmin përmes fjalëve dhe goditjeve 1-2.*



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Mjeshtri i vogël"		**Situata: Profesionet** Nxënësve/eve u tregohen disa fotografi nga profesione të ndryshme, të cilat ata/ato i gjejnë dhe i përshkruajnë. Më pas ata/ato nxiten të flasin për profesionin që parapëlqejnë të bëjnë në të ardhmen.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën duke iu përshtatur përmbajtjes së saj; - shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - CD me melodinë e këngës; - fotografi; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - matematika; - edukimi fizik dhe sportet.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësve/eve u tregohen disa fotografi nga profesione të ndryshme, të cilat i gjejnë dhe i përshkruajnë. Më pas ata/ato nxiten të flasin për profesionin që parapëlqejnë.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi /ja përmes situatës dhe pyetjeve që u bën nxënësve/eve u tërheq vëmendjen për rëndësinë që ka zgjedhja e profesionit. Nxënësit/et sjellin shembujt të ndryshëm, këngë dhe recitime, shkruajnë në dërrasë profesione të tjera që kanë dëshirë të kenë kur të rriten. Gjithashtu, ata/ato identifikojnë edhe ritmin e këngës nëpërmjet fjalëve çak-çak që përkon pikërisht me ritmin me dy goditje dhe numërojnë 1-2.

Më pas nxënësit/et mësojnë këngën "Mjeshtri i vogël" me vargje, strofë dhe e përsëritin disa herë atë deri në përvetësimin e mirë të saj në ritëm dhe intonacion. Ata/ato këndojnë vetëm ose në grup saktë tekstin dhe melodinë e këngës.

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth profesioneve që kanë dëshirë të kenë kur të rriten;
- dallojnë fjalët çak-çak që përkon me goditjet ritmike (1-2);
- këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.

Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re; - këndimin saktë të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - për bashkëpunimin dhe këndimin në grup të këngës.
Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga "Mjeshtri i vogël" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- Këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Mjeshtri i vogël

I

Çak e çak, çak e çak e me çekiç,
punon e këndon,
porsi mjeshtër çak e çak,
e stoli po mbaron.

Refreni

Çik e çak, çik e çak,
punon pa përtesë,
çik e çak, çik e çak,
çekiçi nuk pushon.



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Ndërtojmë instrumente me goditje: *tamburi/zilka/trekëndëshi/shkopinj*		**Situata: Instrumenti im i parapëlqyer** Vendosen në tavolinë disa materiale, të cilat janë ndarë në grupe. Në krah vendoset një fotografi e instrumentit që duhet të ndërtohet me këto materiale. Nxënësit/et udhëzohen se çfarë rruge duhet të ndjekin për ta ndërtuar atë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësit/ja: - ndërton me mjete rrethanore një nga veglat muzikore vetëm ose me të tjerët; - kupton rëndësinë e përdorimit të veglave me goditje; - shoqëron me veglat e krijuara këngë të ndryshme.		**Fjalët kyçe:** - instrumente me goditje; - tambur; - zilkë; - trekëndësh; - shkopinj; - shoqërim.	
Burimet: - CD me tingëllime të instrumenteve me goditje; - teksti i mësuesit. **Materialet:** - letër, karton, ngjyra, gërshërë, vinovil, shkopinj druri, gotë ose kuti në formë cilindrike etj.		**Lidhja me fushat e tjera:** - artet: arti pamor. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** - - identiteti ynë kombëtar.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon duke vendosur në tavolinë disa materiale, të cilat janë ndarë në grupe. Në krah vendoset një fotografi të instrumentit që duhet të ndërtohet me këto materiale. Nxënësit/et udhëzohen se çfarë rruge duhet të ndjekin për ta ndërtuar atë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Materialet grumbullohen së bashku të gjitha, ndërsa nxënësit/et udhëzohen për hapat që do të ndjekin për të ndërtuar instrumentin. Mësuesi/ja u rri pranë atyre duke i mbështetur dhe duke u treguar mënyrën se si duhet të punojnë Nxënësit/et: - ndahen në grupe për ndërtimin e instrumentit me goditje; - ndjekin udhëzimet për ndërtimin e tij; - diskutojnë me njëri-tjetrin për instrumentet me goditje; - provojnë tingëllimin e instrumenteve me goditje dhe i shpjegojnë ato; - shoqërojnë këngët apo këngët-lojë me instrumente me goditje. Nxënësit/et diskutojnë efektet që krijojnë instrumentet me goditje, duke diskutuar rreth ndryshimit të tingëllimit dhe arsyet e këtij ndryshimi, si: *materiali, madhësia etj.* Nxënësit/et shoqërojnë këngën-lojë *"Çova një letër mu në postë"* me instrumentet e krijuara.			

Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në: - përgatitjen dhe ndërtimin e instrumentit me goditje; - ndjekjen e udhëzimeve për ndërtimin e tij; - shoqërimin e këngëve vetëm dhe në grup me instrumentet me goditje që u krijuan.
Detyrë Punimet (instrumentet) ruhen në dosjen e nxënësit/es.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Informacion për mësuesin/en

Hapat që duhet të ndiqni për të udhëzuar nxënësit/et për ndërtimin dhe përdorimin një prej këtyre instrumenteve:

❖ *Shkopinjtë*: Merrni 1 shkop cilindrik rreth 30 cm dhe me diametër jo më shumë se 2 cm. Priteni atë në dy segmente të barabarta prej 15 cm që me to të krijoni dy shkopinj. Për të tingëlluar udhëzoni nxënësit/et që të mos i shtrëngojnë fort, që të mos "bllokojnë" dridhjet (vibracionet) që krijojnë gjatë përplasjes me njëri-tjetrin. Njëri shkop mbahet i mbështetur ndërmjet pëllëmbës dhe gishtave të dorës së majtë, cili goditet me shkopin tjetër që mbahet në dorën e djathtë.

Kërkoni nga nxënësit/et që të veprojnë në këtë mënyrë dhe do të shikoni ndryshimin.



❖ *Trekëndëshi*: Merrni një tub metalik të hollë dhe kthejini anët e tij duke krijuar një trekëndësh. Duke goditur me një shufër metali brenda ose jashtë trekëndëshit do të dëgjoni tinguj të ëmbël.

❖ *Tamburi*: Merrni një gotë plastike (për shembull: të kosit) dhe vendosni mbi të një copë tullumbace. Tendoseni mirë atë tek anët duke e lidhur me një spango ose duke e tendosur mirë me shirit ngjitës. Kërkojuni nxënësve/eve të provojnë të godasin mbi të dhe të dallojnë tingujt që ai do të nxjerrë.

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria

Tema mësimore: Muzika dhe filmi për fëmijë</td><td colspan="2">Situata: Kuic me muzikë filmi
Shfaqen fragmente të shkurtra muzikore nga filma shqiptarë dhe filma të tjerë të ndryshëm për fëmijë. Nxënësit/et të ndarë në grupe gjejnë emrin e filmit nëpërmjet dëgjimit të muzikës. Ata/ato nxiten të flasin pse u pëlqen filmi dhe nëse e zbukuron muzika atë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore
Nxënësi/ja:
- dëgjon me vëmendje muzikën dhe gjen se kujt filmi i përket;
- flet për muzikën e filmit të vet të parapëlqyer;
- reflekton emocionet që i krijon muzika e filmit gjatë dëgjimit të saj.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
- muzikë filmi;
- parapëlqim;
- përjetim emocional.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- CD me shembuj muzikorë nga filma për fëmijë të përgatitur nga mësuesi/ja;
- teksti i mësuesit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
- gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</th></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Mësimi fillon me një veprimtari në formën e një kuici muzikor ku shfaqen fragmente të shkurtra muzikore nga filma shqiptarë dhe filma të tjerë të ndryshëm për fëmijë. Nxënësit/et të ndarë në grupe gjejnë nëpërmjet emrin e filmit dëgjimit të muzikës. Ata/ato nxiten të flasin pse u pëlqen filmi dhe nëse mendojnë që muzika e zbukuron atë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Mësuesi/ja e vazhdon më tej situatën e krijuar, duke e bërë dëgjimin me ndalesa për secilin fragment muzikor të shkëputur nga filma të ndryshëm për fëmijë. Kjo formë pune me nxënësit/et bën që ata/ato të identifikojnë apo të përcaktojnë edhe tematikën që mund të ketë filmi. Ata/ato jo vetëm shprehen rreth muzikës që dëgjojnë, por edhe mundohen të identifikojnë :
- llojin e muzikës së filmit që dëgjojnë: e ëmbël, e shpejtë, e gëzueshme, ritmike etj.;
- instrumentet që luhen gjatë dëgjimit të muzikës;
- ndjesinë që u krijohet kur dëgjojnë muzikë filmi në kinema apo TV;
- pse pëlqejnë më shumë muzikën e filmit vizatimor sesa të filmave të tjerë etj.

Nxënësit/et dëgjojnë me vëmendje fragmente të ndryshme muzikore të shkëputura nga filma vizatimorë të huaj apo shqiptarë (“Tomka dhe shokët e tij”, ”Mbreti Luan”, ”Mimoza llastica”, “Masha dhe ariu” etj.). Ata/ato dallojnë karakteristikat e muzikës që dëgjojnë dhe shprehin emocionet që ndiejnë ose u krijon ajo.
Nxënësit/et flasin duke argumentuar në mënyrë të thjeshtë rreth muzikës që dëgjojnë. Në përfundim ata/ato kanë filluar të krijojnë një mënyrë gjykimi rreth saj dhe kanë mësuar të shprehin emocionet e tyre.</td></tr>
</table>

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi muzikën e filmit për fëmijë;
- përcaktimin e përmbajtjes së filmit vetëm duke dëgjuar muzikën;
- qëndrimin apo gjykimin, teksa shprehet rreth muzikës së filmit për fëmijë me fjalë të thjeshta dhe shpjegon pse e pëlqen atë.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

VEPRIMTARI PËRMES ARTEVE TË TJERA

Duke dëgjuar muzikë nxënësit/et aftësohen që ta kuptojnë atë që dëgjojnë dhe ta shijojnë në mënyra të ndryshme. Kënaqësia ndaj muzikës pasqyrohet te nxënësit/et përmes reagimit emocional ndaj ritmeve të gjalla, teksa ata në të njëjtën kohë këndojnë (ritmi, melodia, teksti), vallëzojnë (lëvizjet e trupit që përkojnë me ritmin dhe muzikën) dhe shoqërojnë muzikën me vegla të ndryshme. Një muzikë e parapëlqyer dhe që mbetet në kujtesën e fëmijëve është edhe muzika e filmit. Dëgjimi i orientuar bën që nxënësit/et ta përjetojnë sa më mirë muzikën e cilitdo lloj qoftë ajo.

Hapi I

Nxënësit/et vëzhgojnë figurat e mëposhtme dhe dëgjojnë fragmente nga filmat përkatës. Ata/ato shkruajnë në një fletë emocionet që u përcjell muzika e secilit film.

Tomka dhe shokët e tij: _____

_____

Mbreti Luan: _____

Mimoza llastica: _____

Masha dhe Ariu: _____



Hapi II

Kërkoju nxënësve/eve të kujtojnë këngën e filmit "Tomka me shokët e tij".

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Këngë-lojë “Huhu ba ba hu”</td><td colspan="2">Situata: Loja e fjalëve
Nxënësit/et të recitojnë këngën-lojë në shpejtësi të ndryshme, duke theksuar rrokjen (goditjen më të gjatë). Nxënësit/et gjatë mësimit të tekstit kuptojnë rëndësinë e theksit të fjalës dhe të goditjes. Teksti i këngës-lojë përsëritet disa herë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:
Nxënësi/ja
- mëson këngën-lojë popullore me tekst dhe me melodi;
- demonstron se ka kuptuar elementet e ritmit dhe të melodisë, gjatë këndimit dhe shoqërimit me lëvizje të trupit apo me instrumente me goditje;
- interpreton këngën-lojë duke dhënë ide në inskenimin e saj;
- respekton interpretimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit;
- këngë-lojë popullore;</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- CD me ritualin popullor;
- instrumente me goditje;
- teksti i mësuesit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
- shkencat natyrore: matematika;
- artet: arti pamor;
- gjuha dhe komunikimi: gjuha.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Mësimi fillon me një veprimtari, ku nxënësit/et recitojnë këngën-lojë me shpejtësi të ndryshme, duke theksuar rrokjet e para (goditjen më të gjatë). Gjatë mësimit të tekstit ata/ato kuptojnë rëndësinë e theksit të fjalës dhe të goditjes. Teksti i këngës-lojë përsëritet disa herë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Mësuesi/ja fillon t’u mësojë nxënësve/eve këngën-lojë “Huhu ba ba hu” varg pas vargu, pasi kjo lloj kënge më shumë këndohet në mënyrë parlando d.m.th. e recituar. Pasi e mësojnë ata/ato provojnë ta shoqërojnë me rrahje të shuplakave, duke u ndarë në dy grupe. Njëri grup këndon, kurse grupi tjetër shoqëron me instrumente me goditje. Më pas nxënësit/et ndërrojnë grupet. Gjithashtu, ata/ato krijojnë simbole përkatëse (të personalizuara) për të treguar se ku është tingulli/fjala e gjatë apo e shkurtër dhe i shpjegojnë ato.</td></tr>
</table>

Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re; - këndimin duke recituar (parlando) të këngës-lojë dhe shoqërimin e saj me goditje të shuplakave; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).
Detyrë: Nëse nxënësit/et kanë bërë punime (vizatimi i dallëndyshes), ato ruhen në dosjet e tyre.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga-lojë "Huhu baba hu" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit e të interpretimit* të këngës

Huhu baba hu

Hu – hu, ba – ba hu
me – rre kalin shko për dru
Pri – te pri – te se po vjen
Bi – shti i ka – lit po kër – cen.
Hu – hu një, hu – hu dy.

Hapi III **Kërkoju nxënësve/eve të shoqërojnë këngën me shkopinj.**



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Gjuha dhe komunikimi muzikor* **Tema mësimore:** Theksi muzikor në ritmin me dy goditje		**Situata: Konkurs** Zhvillohet kuici i shpejtë: kush gjen *fjalë me dy rrokje*. Fjalët me dy rrokje shkruhen në dërrasë. Grupi që gjen më shumë fjalë të tilla fiton konkursin. Nxënësit/et lexojnë fjalët e gjetura dhe gjejnë se në cilën rrokje e forcojnë/ngrenë zërin më shumë. Ai është theksi i fortë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - gjen fjalë me *një* dhe *dy rrokje*; - demonstron kuptimin e theksit në fjalët e gjetura; - krijon modele ritmike me dy goditje, duke theksuar goditjen e parë;		**Fjalët kyçe:** - theks; - theks muzikor; - i fortë – i butë.	
Burimet: - foto ose fisha me fjalë dyrrokëshe të parapërgatitura nga mësuesi; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat natyrore: matematika.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me garën: kush gjen *fjalë me dy rrokje* ose më shumë rrokje. Fjalët me dy rrokje shkruhen në dërrasë. Grupi që gjen më shumë fjalë fiton garën. Më pas ata i lexojnë fjalët e gjetura dhe gjejnë se në cilën rrokje forcohet /ngrihet zëri më shumë. Ai është theksi *i fortë.*			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja më pas i ndan nxënësit/et në grupe dhe u jep fisha me tekste këngësh. Ata/ato i lexojnë dhe vendosin theksin e *fortë dhe të butë* të fjalëve. Poshtë fjalëve të këngëve vendosin simbolin që duan për të treguar se e kuptojnë gjatësinë e tingullit me të cilën përkon çdo rrokje e fjalës. Më pas ata shoqërojnë këngën me goditje të shuplakave ose me instrumente me goditje për të kuptuar më mirë ku bien theksat.			
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: theksi muzikor i ritmit me dy goditje; - bashkëpunimin në mënyrë të pavarur për zhvillimin e detyrës: gjetja e theksit, regjistrimi grafik i tij dhe ritmi me simbole; - si dhe interpretimi i krijimit të realizuar vetëm ose në grup.			
Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.			

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të zhvillojnë në formë ushtrimi vargjet e mëposhtme që janë me të zeza sipas 3 hapave:

1. lexojnë poezinë dhe ndajnë çdo fjalë në rrokje;

2. poshtë çdo fjale vendosin numra, për të kuptuar nga sa rrokje përbëhen fjalët;

3. gjejnë se në cilën rrokje intonacioni i zërit ngrihet dhe fuqizohet. Aty është theksi.

(Shënim: Vargjet për gjyshen janë shkëputur nga vjersha "Balada e burrave" të Odhise Grillo.)

Kur të kujtoj ty,
këngët e përrallat,
gjumi edhe sot
vjen m'i mbyll qepallat...

Moj e mira gjyshe,
kur të sjell në mend,
më kujton një re,
më kujton një shkëmb.

Kur të kuj-toj ty
1 1 1 - 2 1

Hapi II

Vazhdon nxënësi vargjet e tjera



Zog i bukur

Një zog të bukur në pyll zura,
në kafaz atë e vura.

E kam çuar në ballkon
po çka zogu pse s'këndon?

Më mërzitesh vetëm zog,

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Kënga: “Dua Shqipërinë”</td><td colspan="2">Situata: Qyteti im
Nxënësit/et marrin në dorë emrin e qytetit për të cilin dëshirojnë të flasin. Kur thirret emri i qytetit përkatës ai/ajo që ka në dorë fishën thotë disa karakteristika që di për të.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore
Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës;
- interpreton këngët duke respektuar elementet e gjuhës muzikore.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- Shqipëria;</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- CD me melodinë e këngës;
- fisha me emrin e qyteteve, të përgatitura nga mësuesi/ja;
- instrumente me goditje;
- teksti i mësuesit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
- shkencat shoqërore dhe mjedisi: historia;
- artet: arti pamor.</td></tr>
<tr><th colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</th></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Mësimi fillon me një veprimtari-lojë, ku nxënësit/et marrin në dorë emrin e qytetit, për të cilin dëshirojnë të flasin Kur thirret emri i qytetit përkatës ai/ajo që ka në dorë fishën thotë disa karakteristika që di për të.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Mësuesi/ja fillon t’u mësojë nxënësve këngën për fëmijë “Dua shumë Shqipërinë”, duke e mësuar atë varg pas vargu, strofë pas strofe, dhe në fund duke e përsëritur të gjithën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata duhet të këndojnë me ndjenjë dhe emocion, dhe në grup. Ata/ato:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth atdheut të tyre, Shqipërisë dhe krahinës së tyre.
- këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit, në ritëm dhe intonacion.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi
- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për rezultatet e arritura në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin e saktë të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrë: Punimet (vizatime të ndryshme) që kanë bërë nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre.</td></tr>
</table>

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

✇ **Dëgjohet** këngа "Dua më shumë Shqipërinë" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet këngа varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet këngа nga fillimi në fund;
- interpretohet këngа me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet këngа vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Dua më shumë Shqipërinë

I
Un' e dua mamin,
e dua edhe babin,
motrën dhe mësuesen,
lulet në lëndinë.

II
Por më shumë se çdo gjë,
unë dua Shqipërinë,
Shqipërinë dhe lirinë,
që na sjellin lumturinë.





PLANIFIKIMI TREMUJOR, LËNDA MUZIKË, PERIUDHA: JANAR– MARS

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
Nxënësi/ja:
1. aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike;
2. kupton simbolet muzikore që i shfaqen;
3. shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve muzikore;
4. komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë.

Kompetenca e të menduarit
Nxënësi/ja:
1. mendon në mënyrë krijuese;
2. merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese;
3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese;
4. kupton ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
Nxënësi/ja:
1. përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor;
2. përdor burime e gatshme për të realizuar një krijim muzikor;
3. zbaton detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
Nxënësi/ja:
1. bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës.

Kompetenca personale
Nxënësi/ja:
1. zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore;
2. respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
3. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave.

Kompetenca qytetare
Nxënësi/ja:
1. diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.

Kompetenca digjitale
Nxënësi/ja:
1. njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
Krijimi muzikor	***Interpretimi muzikor***	***Vlerësimi muzikor***
Nxënësi/ja: • kërkon dhe zbulon shumëllojshmëri burimesh ritmike dhe melodike (tingullore); • imiton dhe demonstron kuptimin e karakteristikave të tingujve muzikorë ose jo muzikorë; • improvizon modele të ndryshme ritmike ose jo ritmike; • demonstron zbatimin e elementeve të gjuhës muzikore, gjatë krijimeve të ndryshme; • komunikon njohuritë rreth gjuhës muzikore; • provon të improvizojë mbi një këngë apo melodi ritmin dhe karakterin duke përdorur elemente të tjera si: lëvizjet e trupit.	Nxënësi/ja: • interpreton gjatë këndimit, këngë dhe lojëra për fëmijë; • demonstron gjatë luajtjes nëpërmjet lëvizjeve të trupit trupore apo instrumenteve fëmijërore me goditje se ka kuptuar elementet e ritmit dhe të melodisë; • këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; • interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës; • interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; • interpreton lojërat muzikore duke ndihmuar në inskenimin e tyre; • respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera; • komunikon mendimin e vet rreth këngës apo lojës muzikore; • reflekton emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo pjesë muzikore gjatë interpretimit.	Nxënësi/ja: • shpreh qartë emocionet e veta ndaj muzikës; • jep mendimin e vet gjatë shpjegimit emocional të këngës, duke përdorur një gjuhë të thjeshtë muzikore; • fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë muzikor për t'u shprehur në mënyrë artistike; • shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet e veta muzikore; • shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon; • përdor elementet e gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional; • përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; • bën lidhje ndërmjet asaj që përjeton dhe asaj që dëgjon nga një këngë, lojë muzikore apo fragment muzikor; • shpreh mendimin e vet rreth këngës/pjesës që dëgjon; • merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës, përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar punën e vet dhe të të tjerëve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

	NR.	TEMATIKA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT	BURIMET
	1	*Teknika dhe procese*	Këngë lojë: ”Gjuha e kafshëve”	**Situata: Një ditë në fshat/ kopshtin zoologjik** Nxënësit/et imitojnë veprimet që ata bëjnë kur ju rastis të komunikojnë me një kafshë apo shpend psh: një qen, një mace, një zog. Çfarë gjuhe përdorin ata? A mendojnë se kafshët apo shpendët I kuptojnë? Nëse jo pse?	- CD; - magnetofon; - fotografi të ndryshme; - teksti i mësuesit.
	2	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Tempi - shpejtësia *ngadalë-shpejt*	**Situata: Loja e veprimeve sipas muzikës** Dy nxënës/e improvizojnë veprime, sipas imagjinatës së tyre nën tingujt e muzikës që dëgjojnë. Pastaj ata/ ato thonë se çfarë ndien dhe pse i bënë ato veprime të ndryshme nga njëri-tjetri.	CD; - magnetofon; - fotografi të ndryshme; - teksti i mësuesit.
	3	*Teknika dhe procese*	Luajmë me instrumente me goditje *Rituali popullor: “Rona Rona peperona”*	**Situata: Loja e shkopinjve** Nxënësve/eve u kërkohet të krijojnë simbole grafike që nënkuptojnë një goditje të shkurtër ose të gjatë dhe të krijojnë përmes tyre modele	- CD; - instrumente me goditje, si: tamburi, zilka, trekëndëshi, shkopinj etj.; - teksti i mësuesit.

				ritmike, sipas dëshirës. Ata/ato i ekzekutojnë këto ritme me shkopinj dhe diskutojnë me njëri-tjetrin nëse përftohet një ritëm i rregullt.	
	4	*Historia, muzika dhe shoqëria*	Shprehim emocionet për muzikën përmes arteve të tjera	**Situata: Më pëlqen kjo muzikë se** Dëgjohen disa fragmente muzikore me këngë për fëmijë, muzikë filmi, valse etj. Nxënësit/et kuptojnë ndjesinë dhe emocionin që u krijon muzika, duke u shprehur për të sipas mënyrës së tyre.	- CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	5	*Teknika dhe procese*	Kënga: "Ëndrra"	**Situata: Kam dëshirë…** Nxënësit/et përshkruajnë dëshirat e tyre për profesionin që duan të bëjnë kur të rriten dhe i diskutojnë ato me njëri-tjetrin.	- CD; - fotografi të ndryshme; - teksti i mësuesit.
	6	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Tingujt e rregullt dhe të parregullt	**Situata: Loja e gotave** Mbi tavolinë vendosen 6 gota uji. Çdo gotë mbushet me ujë në masa të ndryshme për të përftuar tinguj të ndryshëm. Nxënësit/et vendosin numrat para gotave dhe fillojnë të krijojnë një kombinim numrash nga	- 6 gota; - 1 lugë/shkop; - teksti i mësuesit.

				1-6. Çfarë do të përftohet nga goditja e tyre? Bezdi? Tinguj të këndshëm? Tinguj të mërzitshëm? Ata/ato diskutojnë dhe shprehin çka dëgjojnë.	
	7	*Teknika dhe procese*	Kënga "Festa e mësuesit"	**Situata: Muaji i festave** Nxënësit/et përmendin tri festat që pëlqejnë më shumë, duke vendosur brenda tri pemëve me ngjyra të ndryshme dëshirat e tyre se si do të donin t'i festonin ato. Secili grup paraqet pemën e vet me mënyrën se si do të donin të festonin festa të ndryshme, si: ditëlindje, festën e Nënës, festën e Mësuesit, festën e Vitit të Ri etj.	- CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	8	*Teknika dhe procese*	Shoqërojmë këngët me lëvizje të trupit	**Situata: Karamele zana** Nxënësit/et recitojnë dhe shoqërojnë me shuplaka *lojëzën* shumë të njohur *karamele zana.* Lojëza shoqërohet duke i përplasur shuplakat me njëra-tjetrën dhe mbi gjunjë. Vendosen këngë të ndryshme dhe shoqërohen me shuplaka sipas ritmit që kanë.	- CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.

	9	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Vetitë e tingujve	**Situata: Loja e bankave** Nxënësve/eve u kërkohet të rrahin mbi bankë me çdo mjet që kanë në dorë, për rreth 10 sekonda. Çfarë do të përftohet nga kjo gjë? A janë tinguj të këndshëm apo të pakëndshëm ata që dëgjohen? Si mund të quhen ndryshe? Ata/ato diskutojnë karakteristikat e tingujve me njëri-tjetrin.	- mjete rrethanore: lapsa, vizore, etj.; - teksti i mësuesit.
	10	*Teknika dhe procese*	Kënga: "Fjalët magjike na pëlqejnë"	**Situata: Gjëegjëzë** *Sjellja zbukuron njeriun.* *Kush sillet mirë nderon veten dhe familjen.* *Përdorim fjalët magjike kurdo dhe kudo.* Vendosen disa fisha me fjalë të ndryshme. Nxënësit/et ndahen në 3 grupe dhe mundohen të krijojnë fjalitë e mësipërme. Pasi i kanë krijuar flasin për fjalët magjike.	- CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	11	*Historia, muzika dhe shoqëria*	Muzika për fëmijë	**Situata: Shprehim emocionet** Nxënësit/ et dëgjojnë në CD fragmente të ndryshme muzikore: këngë për fëmijë, muzikë nga filmat për	- CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.

				fëmijë, muzikë popullore etj. Ata/ ato lihen të lirë të shprehin emocionet përmes vizatimit, kërcimit, tregimit, poezisë etj.	
	12	*Teknika dhe procese*	Koncert		

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Këngë-lojë: "Gjuha e kafshëve"		**Situata: Një ditë në fshat/kopshtin zoologjik** Nxënësit/et imitojnë veprimet që bëjnë nëse komunikojnë me një kafshë apo shpend, si: një qen, një mace, një zog. Çfarë gjuhe përdorin ata? A mendojnë se kafshët apo shpendët i kuptojnë? Nëse jo, pse?	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën duke iu përshtatur përmbajtjes së saj; - shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - CD me melodinë e këngës; - fotografi të përgatitura nga mësuesi/ja ose objekte që nënkuptojnë profesione të caktuara; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat e natyrës; - shkencat shoqërore dhe mjedisi; - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - artet: arti pamor.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit/et imitojnë veprimet që bëjnë nëse komunikojnë me një kafshë apo shpend, si: një qen, një mace, një zog. Çfarë gjuhe përdorin? Shkruajnë në dërrasë të zezë *gjuhën e tyre,* duke e identifikuar me tinguj të gjatë dhe të shkurtër në muzikë. A mendojnë se kafshët apo shpendët i kuptojnë? Nëse jo, pse? Si duhet të kujdesemi për kafshët? Tregohen ngjarje të përjetuara.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi /ja përmes situatës dhe pyetjeve që bën u tërheq vëmendjen nxënësve/eve për *njohuritë që kanë marrë për tingujt e shkurtër dhe të gjatë.* Në dërrasë shkruhet gjuha e kafshëve: mjau (e gjatë); ciu –ciu (e shkurtër); muuu (e gjatë) etj. Nxënësit/et sjellin shembuj të ndryshëm, këngë të tjera dhe recitime, ata/ato flasin për kafshën e tyre të parapëlqyer, si flasin me të në shtëpi (ata që e kanë) etj. Kështu ata/ato identifikojnë edhe gjatësinë e tingujve nëpërmjet fjalëve *ciu-ciu* që përkon pikërisht me ritmin me dy goditje të shkurtra dhe krijojnë simbole grafike për tinguj *e gjatë – të shkurtër dhe shumë të shkurtër*

Tingull i *gjatë, i shkurtër, shumë i shkurtër*

Më pas ata/ato mësojnë këngën "Gjuha e kafshëve"me vargje, strofë dhe e përsëritin disa herë atë deri në përvetësimin e mirë të saj, në ritëm dhe intonacion. Ata/ato këndojnë vetëm ose në grup saktë tekstin dhe melodinë e këngës. Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth profesioneve që pëlqejnë më shumë; - dallojnë fjalët ciu-ciu që përkojnë me goditjet ritmike (1-2), por edhe me gjatësinë e tingullit të shkurtër ose shumë të shkurtër; - këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re; - këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - për bashkëpunimin dhe këndimin në grup të këngës.
Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjt e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga "Gjuha e kafshëve" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Gjuha e kafshëve

I
Ciu-ciu-ciu, o zog i vogël,
ciu-ciu,
qan apo këndon?
Ciu-ciu.

II
Ciu-ciu,
flas me nënën time
nëna gjuhën ma kupton,
ciu-ciu-ciu.



Hapi III

Nxënësit/set të vazhdojnë, duke ndërruar grupet, të këndojnë si bëjnë delja, kali, lopa, pula etj.



Informacion për mësuesin

Kënga/lojë ashtu si e kemi thënë edhe vitin e kaluar ka si qëllim jo vetëm mësimin dhe këndimin e këngës, por edhe kombinimin e saj me lëvizje trupore ose krijimin e një minikoreografie nga ana e nxënësve nën udhëheqjen e mësuesit/es. Si mundni ju ta bëni këtë minikoreografi për të zhvilluar dhe arritur kërkesat që ka kënga/lojë.

Ndajeni klasën në aq grupe sa kafshë përmenden në këngë dhe secili grup ka solistin e tij. Kënga/lojë zhvillohet në formën e një bisede muzikore ku secili grup i drejton pyetjen solistit, që mban emrin e kafshës si: zogut, deles, maces etj., dhe solisti ia kthen përgjigjen, duke u shoqëruar nga secili grup me rrahjen e shuplakave. Grupet ndërrojnë rolet e tyre dhe kjo bën që ata të provojnë të gjitha rolet e kafshëve. Më poshtë do të gjeni edhe skemën se si ju duhet të kombinoni muzikën me shoqërimin ritmik. Aty ku shikoni 1-2., kënga duhet shoqëruar me duartrokitje.



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Gjuha dhe komunikimi muzikor* **Tema mësimore:** Tempi - shpejtësia *ngadalë-shpejt*		**Situata: Loja e veprimeve sipas muzikës** Dy prej nxënësve/eve improvizojnë veprime sipas imagjinatës së tyre nën tingujt e muzikës që dëgjojnë. Pastaj ata/ato thonë se çfarë ndien dhe pse bënë ato veprime të ndryshme nga njëri-tjetri.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kupton se ka 2 shpejtësitë bazë muzikore (*ngadalë -shpejtë*); - përcakton llojin e shpejtësisë muzikore që dëgjon *i shpejtë – i ngadaltë;* - demonstron kuptimin e shpejtësisë nëpërmjet lëvizjeve trupore; - argumenton mendimin e vet pse i pëlqen ose jo një muzikë apo këngë e shpejtë; - respekton mendimin e të tjerëve.		**Fjalët kyçe:** - temp; - i shpejtë; - i ngadaltë.	
Burimet: - CD me shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - shkencat e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një situatë ku dy nxënës/e mbajnë kufje në vesh dhe secili/a improvizon lëvizje sipas imagjinatës së vet nën tingujt e muzikës që dëgjon. Pastaj ata/ato thonë se çfarë ndien dhe pse bënë ato veprime të ndryshme nga njëri-tjetri.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja tregon disa fotografi kafshësh dhe nxënësit/et identifikojnë llojin e shpejtësisë të kafshëve të ndryshme dhe flasin për të. Ata/ato shënojnë poshtë figurës së çdo kafshe shpejtësinë që mendojnë se ajo kryen gjatë lëvizjes së vet. Në vijim dëgjohet pjesa "Fluturimi i brumbullit" nga Korsakov dhe u kërkohet nxënësve/eve të thonë se çfarë shpejtësie muzikore dëgjojnë, nëse u pëlqen muzikë kaq e shpejtë Apo e ngadaltë dhe pse. Nxënësit/et, dëgjojnë me vëmendje fragmente të ndryshme muzikore dhe dallojnë shpejtësinë, me të cilën luhen, dhe i shoqërojnë ato me lëvizje trupore.			

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re: tempi;
- diskutimin dhe mendimin në mënyrë të pavarur për shpejtësinë muzikore që dëgjon dhe pëlqen më shumë;
- shoqërimin e muzikës me lëvizje trupore, vetëm ose në grup.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE

Hapi I

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet që të shkruajnë me fjalë poshtë çdo kafshe që shikojnë shpejtësinë që i karakterizon ato.**

kërmilli – shumë i ngadaltë
elefanti – i ngadaltë
majmuni – i shpejtë
luani – i shpejtë
pula – mesatare







Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Luajmë me instrumente me goditje *ritualin popullor: "Rona Rona peperona"*		**Situata: Loja e shkopinjve** Nxënësve/eve u kërkohet që të krijojnë simbole grafike që nënkuptojnë një goditje *të shkurtër apo të gjatë.* Ata/ato krijojnë modele ritmike sipas dëshirës dhe i ekzekutojnë me shkopinj. Në vijim, diskutojnë me njëri-tjetrin, nëse është i rregullt ritmi që përftohet.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: - Shoqëron me instrumente të thjeshta me goditje *ritualin popullor: Rona Rona peperona*; - mëson ritualin popullor; - Improvizon ritme të thjeshta me instrumentet; - Shoqëron këngët solo dhe në grup.		**Fjalët kyçe:** - instrumente me goditje; - tamburi; - zilka; - trekëndësh; - shkopinj.	
Burimet: - instrumente me goditje, si: *tamburi, zilka, trekëndëshi, shkopinj etj.* - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - artet: arti pamor. **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** - identiteti ynë kombëtar.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësve/eve u kërkohet të krijojnë simbole grafike që nënkuptojnë një goditje *të shkurtër apo të gjatë*. Përmes tyre ata/ato krijojnë sipas dëshirës modele ritmike dukeshe i ekzekutojnë ato me shkopinj. Ata/ato diskutojnë modelet me njëri-tjetrin dhe nëse përftohet një ritëm i rregullt kur i luajnë ato.			
Ndërtimi i njohurive të reja Shoqërimi mund të bëhet me instrumentet e ndryshme, për të cilat është folur dhe që nxënësit/et kanë ndërtuar deri tani. Nxënësit/et mund të zgjedhin instrumentin që pëlqejnë më shumë ose atë që kanë mundësi të gjejnë. Në vijim, sipas udhëzimeve të mësuesit/es, nxënësit/et e shoqërojnë atë dhe mësojnë së bashku ritualin popullor. Që të përfshihen të gjithë në veprimtarinë mësimore duhet të krijohen disa grupe ku secili prej tyre shoqëron me instrumentet ritualin. nxënësit/et mund të këmbejnë instrumentet ndërmjet tyre, për të provuar ndjesinë e shoqërimit me instrumente të ndryshme..Ata/ato: - ndahen në grupe për shoqërimin e ritualit; - diskutojnë me njëri-tjetrin për emocionet që ndiejnë kur shoqërojnë ritualin me instrumentet me goditje, por edhe me lëvizje trupore. Nxënësit/et diskutojnë për efektet që krijojnë instrumentet me goditje, gjatë shoqërimit të ritualit, dhe cili prej tyre do të ishte më i përshtatshëm për shoqërimin e saj.			

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- - shoqërimin e ritualit me instrumente me goditje në grup;
- - ndjekjen e udhëzimeve gjatë shoqërimit të ritualit;
- - shoqërimin e këngëve të tjera në grup me instrumentet me goditje të përgatitura nga ai/ajo dhe të tjerët.

Detyrë: Incizimet, filmimet, fotografitë gjatë orës mësimore mund të ruhen në dosjen e nxënësit/es.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE

Hapi I



Rona – rona peperuna,
bjerë shi në arat tona,
të na rritet bereqeti,
le të hajë gjith'mileti.

Hapi II

Kërkoju nxënësve të luajnë modelet ritmike të mëposhtme:



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Shprehim emocionet për muzikën përmes arteve të tjera		**Situata: Më pëlqen kjo muzikë, sepse** Dëgjohen disa fragmente muzikore nga *këngë për fëmijë, muzikë popullore, vals, modern* dhe u kërkohet nxënësve/eve që të *shprehin emocionet,* nëpërmjet arteve të tjera, sipas dëshirës.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon me vëmendje muzikën dhe përjeton emocionet që i jep ajo; - flet për muzikën e vet të parapëlqyer duke shpjeguar pse e pëlqen atë; - reflekton emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj, nëpërmjet arteve të tjera, si: *kërcim, ese, poezi, vizatim etj*.		**Fjalët kyçe:** - parapëlqim muzikor; - përjetim emocional.	
Burimet: - CD me shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - artet: kërcimi, arti pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me dëgjimin e disa fragmenteve muzikore nga *këngë për fëmijë, muzikë popullore, vals, modern etj.,* dhe u kërkohet nxënësve/eve *shprehja e emocioneve,* nëpërmjet arteve të tjera, sipas dëshirës. Ata/ato nxiten të përjetojnë muzikën dhe t'i shprehin emocionet, duke përdorur një art tjetër .			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja zhvillon më tej mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të ndahen në dy – tri grupe dhe të zgjedhin artin me të cilin dëshirojnë të shprehin emocionet ose të realizojnë një punë arti gjatë dëgjimit dhe përjetimit të muzikës. Muzika mund të sugjerohet ose të përzgjidhet nga vetë ata/ato (në përputhje me moshën e tyre). Nxënësit/et udhëzohen se si duhet të punojnë dhe ndihmohen me ide gjatë punës së tyre. Ata interpretojnë ose tregojnë punën e realizuar nga grupi ose në mënyrë individuale. Më pas bëhet vlerësimi i punës më të mirë. Ata/ato flasin duke argumentuar në mënyrë të thjeshtë rreth krijimit më të mirë dhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor. Muzika që dëgjojnë dhe krijimet e tyre janë një formë e shprehjes emocionale.			
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: shprehja e emocioneve përmes arteve të tjera; - krijimin e punëve individuale ose në grup, nëpërmjet muzikës së dëgjuar; - qëndrimin apo gjykimin, që shpreh me fjalë të thjeshta rreth krijimit më të mirë duke shpjeguar pse e vlerëson dhe e pëlqen atë.			
Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit, ruhen në dosjen e tyre personale.			

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE PËRMES ARTEVE TË TJERA

Hapi I

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet që të kërcejnë sipas dëshirës.**

Hapi II

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet që të vizatojnë ose të ngjyrosin një vizatim të gatshëm, sipas ndjesive që u jep muzika që dëgjojnë.**



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga "Ëndrra"		**Situata: Kam dëshirë…** Nxënësit/et flasin për dëshirat e tyre (të marr nota të mira, të blej lodrën time të parapëlqyer, të shkoj në kinema) ose për profesionin që duan të bëjnë kur të rriten, për ëndrrat që kanë etj, dhe diskutojnë me njëri-tjetrin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën duke iu përshtatur përmbajtjes së saj; - shpreh emocionet e veta për këngët që këndon apo lojërat muzikore që luan.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit.	
Burimet: - CD me melodinë e këngës; - situatë e parapërgatitur apo tregim rreth dëshirave; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe - artet: arti pamor	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit/et flasin për dëshirat e tyre (të marr nota të mira, të blej lodrën time të parapëlqyer të shkoj në kinema) ose për profesionin që duan të bëjnë kur të rriten, për ëndrrat që kanë dhe diskutojnë me njëri-tjetrin. Mund t'u kërkohet që të flasin edhe për qiellin, hënën, yjet dhe emocionet që provojnë gjatë soditjes etj.

Detyrë: Nxitini nxënësit/et të tregojnë një ëndërr të bukur që kanë pare dhe ta diskutojnë atë me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja

Mësuesi/ja përmes situatës dhe pyetjeve që u bën nxënësve/eve u tërheq vëmendjen në tematika të ndryshme rreth këngëve që dinë. Në vijim dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti e melodia me fraza ose fjali. Nxënësit nxiten që të këndojnë të gjithë, duke u kujtuar njëkohësisht pozicionin dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe mund të shoqërohet me zilka. Më pas nxënësve/eve u kërkohet që të shprehin përmes vizatimit ëndrrën e tyre më të bukur.

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin e saktë të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- për bashkëpunimin dhe këndimin në grup të këngës.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga "Ëndrra" dhe **vazhdohet** puna për mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Ëndrra

I
Një ëndërr të bukur
un' e shikoj.
Duket sikur nisem
të fluturoj,

II
Dua të fluturoj
e të ngjitem lart në re
E të bëhem yll,
të shkëlqej si një diell

Refreni
Por kur nis të udhëtoj,
qiellit i afrohem.
Sapo diellin e takoj,
më del ëndrra e zgjohem.
Unë do ngjitem lart në re,
se e ndjej në zemër,
sa vjen ora shkoj e fle,
ta shikoj në ëndërr.

Teksti: Jorgo Papingji
Muzika: Agim Rrëza



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Gjuha dhe komunikimi muzikor* **Tema mësimore:** Tingujt e rregullt dhe të parregullt		**Situata: Loja e gotave** Mbi tavolinë vendosen 6 gota uji. Çdo gotë mbushet me ujë në masa të ndryshme për të përftuar tinguj të ndryshëm. Nxënësit/et vendosin numrat para gotave dhe fillojnë të krijojnë një kombinim numrash nga 1-6. Çfarë do të përftohet nga goditja e tyre? Bezdi? Tinguj të këndshëm? Tinguj të mërzitshëm? Ata/ato diskutojnë dhe shprehin çka dëgjojnë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - kupton se ka dy shpejtësi bazë muzikore, *ngadalë - shpejt*; - përcakton llojin e shpejtësisë muzikore që dëgjon, *i shpejtë - i ngadaltë;* - demonstron kuptimin e shpejtësisë nëpërmjet lëvizjeve trupore; - argumenton mendimin e vet pse i pëlqen ose jo një muzikë apo këngë e shpejtë; - respekton mendimin e të tjerëve.		**Fjalët kyçe:** - tinguj të rregullt; - tinguj të parregullt; - zhurmë.	
Burimet: • shembuj muzikorë të parapërgatitura nga mësuesi/ja; • 6 gota; • 1 shkop/lugë; • teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - shkencat e natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mbi tavolinë vendosen 6 gota uji. Çdo gotë mbushet me ujë në masa të ndryshme për të përftuar tinguj të ndryshëm, duke i goditur pa një ritëm të caktuar, por sipas dëshirës. Çfarë do përftohet nga goditja e tyre? Nxënësit/et diskutojnë me njëri-tjetrin për veprimtarinë që bënë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Pas situatës së parë, mësuesi/ja, vendos numrat para gotave dhe së bashku me nxënësit/et fillojnë të krijojnë një kombinim numrash nga 1-6. Mësuesi/ja kërkon që një nga nxënësit/et të marrë shkopin/lugën dhe të fillojë të godasë sipas numrave që mësuesi/ja ose një nxënës/e. P.sh: **3-2-1 3-2-1 ose 6-5-4-3 6-4-4-3 etj.** 			

Çfarë tingujsh përftohen nga goditja e gotave? Si janë këto tinguj? Tinguj të këndshëm apo të mërzitshëm? Të rregullt apo të parregullt? Ku ndryshojnë ata nga njëri-tjetri dhe pse? Nxënësit-et diskutojnë, duke shprehur atë që dëgjojnë.
Ata/ato punojnë në grupe dhe fillimisht mundohen t'u përgjigjen pyetjeve:
- Çfarë të dhënash na jep loja? A kemi realizuar muzikë nëpërmjet tingujve të rregullt të kësaj loje?
- Cilat janë mundësitë që të kemi modele të ndryshme të përftimit të melodive përmes lojës me gota?
- A mund të krijojmë muzikë me mjete të ndryshme tingullore nëpërmjet goditjeve të rregullta?

Nxënësit/et ndryshojnë vendet e numrave dhe përftojnë tinguj të ndryshëm, duke krijuar melodi të ndryshme dhe atmosferë pozitive në klasë.

Vlerësimi
- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: tingujt e rregullt dhe të parregullt;
- diskutimin dhe mendimin në mënyrë të pavarur për tingujt e rregullt dhe përftimin e melodive përmes tyre;
- krijimin e muzikës nëpërmjet modeleve që ka bërë vetë ose bashkë me të tjerët.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE PËRMES ARTEVE TË TJERA

Hapi I

✓ **Veprimtaria "Si të bëjmë muzikë nëpërmjet gotave me ujë" hap pas hapi**

Nxënësit/et:
- vendosin numra para gotave dhe bashkë me mësuesin/en fillojnë të krijojnë një kombinim numrash nga 1-6;
- një prej tyre merr shkopin/lugën dhe fillon të godasë sipas numrave që mësuesi/ja ose shoku/shoqja thërret: **3-2-1 3-2-1 ose 6-5-4-3 6-4-4-3 etj.**
- diskutojnë rreth melodisë që krijohet dhe tingujve që përftohen nga goditja e gotave.
- flasin për tingujt, nëse janë të këndshëm apo të mërzitshëm, të rregullt apo të parregullt, ku ndryshojnë ata nga njëri-tjetri dhe pse.

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga "Festa e mësuesit"		**Situata: Muaji i festave** Nxënësit/et përmendin tri festat që pëlqejnë më shumë, duke vendosur brenda tri pemëve me ngjyra të ndryshme dëshirat e tyre se si do të donin t'i festonin ato. Secili grup paraqet pemën e vet me mënyrën se si do të donin të festonin festa të ndryshme, si: ditëlindje, festën e Nënës, festën e Mësuesit, festën e Vitit të Ri etj.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën duke iu përshtatur përmbajtjes së saj; - shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës; - rregullat e këndimit; - festa.	
Burimet: - CD me melodinë e këngës; - fotografi të ndryshme rreth festave; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - shkencat shoqërore dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë; - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - artet: arti pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësit/et përmendin tri festat që pëlqejnë më shumë, duke vendosur brenda tri pemëve me ngjyra të ndryshme dëshirat e tyre se si do të donin t'i festonin ato. Secili grup paraqet pemën e vet me mënyrën se si do të donin të festonin festa të ndryshme, si: ditëlindje, festën e Nënës, festën e Mësuesit, festën e Vitit të Ri etj.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi /ja përmes situatës dhe pyetjeve që u bën nxënësve/eve u tërheq vëmendjen rreth festave të ndryshme që kanë festuar në klasë, shkollë, familje apo komunitet. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD dhe mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. nxënësit/et nNxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe shoqërohet me zilka. U kërkohet që ata të skicojnë përmes vizatimit festën që atyre u ka bërë më shumë përshtypje.			
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (mësimi i këngës); - këndimin saktë të këngës në ritëm dhe intoancion, duke respektuar rregullat e këndimit; - për bashkëpunimin dhe këndimin në grup të këngës.			

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga "Festa e mësuesit" dhe **vazhdohet** puna për mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet e kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Festa e mësuesit

I
O mësues i dashur,
ne të duam shumë,
ti për ne je prind i dyt'
që na edukon.

Refreni
Festën e mësuesit t' gjith'
ne do ta festojmë
lulet më tëbukura
ne do i dhurojmë.

II
Ne në shkollë shkojmë
gjithmonë të gëzuar
dhe mësimet i mësojm'
si na ke mësuar.

Allegretto — *Muzika: Vangjo Nova*



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Shoqërojmë këngët me lëvizje trupore		**Situata: Karamele zana** Nxënësit/et fillojnë të recitojnë dhe të shoqërojnë me shuplaka *lojëzën* e njohur "*karamele zana"*. Lojëza shoqërohet duke përplasur shuplakat me njëra-tjetrën edhe mbi gjunjë. Dëgjohen këngë të ndryshme dhe shoqërohen me goditjen e shuplakave sipas ritmit që kanë.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - shoqëron me lëvizje trupore lojën për fëmijë "*karamele zana"* dhe këngë të ndryshme; - shoqëron këngë të ndryshme për fëmijë me lëvizje trupore; - improvizon modele ritmike nëpërmjet lëvizjeve të trupit.		**Fjalët kyçe:** - lëvizje trupore; - këngë; - lojëra muzikore popullore, për fëmijë.	
Burimet: - lëvizje trupore; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - artet: arti pamor.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Mësimi fillon duke kujtuar këngën e njohur "*karamele zana"*. Nxënësit/et e recitojnë dhe e shoqërojnë *lojëzën* me shuplaka që i përplasin me njëra-tjetrën dhe mbi gjunjë, duke ndjekur ritmin.

Ndërtimi i njohurive të reja

Shoqërimi i këngëve apo i këngëve-lojë për fëmijë gjatë kësaj ore do të bëhet vetëm me lëvizje të trupit (përplasjen e duarve me njëra-tjetrën dhe mbi gjunjë). Kjo bëhet që nxënësit/et të forcojnë *ndjenjën ritmike* dhe të edukohen nëpërmjet saj.

Në fillim fillohet me një këngë, këngë-lojë apo ritual të mësuar dhe mjaft të njohur për ta, pasi kështu e kanë më të lehtë kombinimin e ritmit, të lëvizjeve trupore dhe të fjalëve.

Nxënësit/et ndahen në grupe:

1) *Grupi i parë* këndon duke recituar (parlando) ritualin *"Rrodhe rrodhe kokorrodhe"*.
2) *Grupi i dytë* shoqërojnë me shuplaka ritualin sipas udhëzimeve të mësuesit/es..

Në veprimtarinë mësimore duhet të përfshihen të gjithë. Mësuesi/ja duhet të krijojë kushtet që grupet të arrijnë të këndojnë duke recituar (parlando) dhe të mbajnë ritmin me shuplaka, saktë dhe bukur. Gjithashtu, nxënësit/et mund t'i ndërrojnë rolet që kanë, gjatë interpretimit të ritualit.

Ata/ato diskutojnë me njëri-tjetrin për emocionet që ndiejnë, teksa shoqërojnë ritualin me lëvizjet trupore.

Dëgjohen këngë të ndryshme dhe shoqërohen me përplasje të shuplakave, sipas ritmit që kanë.

Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në: - shoqërimin e ritualit me lëvizje trupore në grup; - ndjekjen e udhëzimeve gjatë shoqërimit të ritualit; - shoqërimin e këngëve të tjera në grup.
Detyrë: Incizimet, filmimet dhe fotografitë gjatë orës mësimore ruhen në dosjen e nxënësit/es.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE PËRMES ARTEVE TË TJERA

Hapi I

✓ **Nxënësit/et zhvillojnë lojën "Karamele Zana" duke e shoqëruar përplasje të shuplakave.**

✓ **Nxënësit/et shoqërojnë ritualin "rrodhe-rrodhe" me lëvizje trupore (përplasje të shuplakave me njëra-tjetrën dhe mbi gjunjë).**



○ Ky është një ritual mjaft i njohur për ta/to, kështu që e kanë të lehtë kombinimin e ritmit, të lëvizjeve trupore dhe të fjalëve.

Hapi II

Nxënësit/et ndahen në grupe:

1) *Grupi i parë* këndon duke recituar (*parlando*) ritualin *"Rrodhe-rrodhe kokorrodhe"*.
2) *Grupi i dytë* shoqëron me shuplaka ritualin, sipas udhëzimeve të mësuesit/es..

Mësuesi/ja duhet të krijojë kushte në mënyrë që të dyja grupet të arrijnë të këndojnë *parlando* dhe të mbajnë ritmin me shuplaka, saktë dhe bukur.

Nxënësit/et mund të ndërrojnë rolet që kanë gjatë interpretimit të ritualit.

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet të zbatojnë ritmin e mëposhtëm.**

Rrodhe rrodhe

Rrodhe-rrodhe koko-rrodhe,
Nëm atë që më vodhe,
S'është e imja, është e huaj,
S'kam para ta paguaj. (Përsëritet disa herë)

Hapi III



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Gjuha dhe komunikimi muzikor* **Tema mësimore:** Vetitë e tingujve		**Situata: Loja e bankave** Nxënësve/eve u kërkohet që të rrahin mbi banka me çdo mjet që ata/ato kanë në dorë, për rreth 10 sekonda. Çfarë do të përftohet nga kjo gjë? A janë tinguj të këndshëm apo të pakëndshëm ato që dëgjohen? Si mund të quhen ndryshe? Ata/ato diskutojnë karakteristikat e tingujve me njëri-tjetrin.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dallon tingujt: *të gjatë – të shkurtër; të lartë – të ulët, të fortë – të butë;* - demonstron përmes këndimit karakteristikat e tingujve të mësipërm; - dallon *karakteristikat e tingujve* në këngët e mësuara.		**Fjalët kyçe:** - vetitë e tingujve - i gjatë/ i shkurtër - i lartë / i ulët - i fortë/ i butë	
Burimet: • CD shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja; • mjete të ndryshme rrethanore; • magnetofon; • teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - shkencat e natyrës; - artet: arti pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të godasin mbi banka me çdo mjet që kanë në dorë ose të këndojnë për rreth 2-3 sekonda. Çfarë do të përftohet nga kjo gjë? Tingujt që dëgjohen janë të këndshëm apo të pakëndshëm? Si mund të quhen ndryshe? Ata/ato diskutojnë karakteristikat e tingujve me njëri-tjetrin.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja e zhvillon mësimin me tri ndalesa, duke e ndarë dëgjimin e tingujve dhe gjetjen e karakteristikave të tyre në tri momente. Ai/ajo mund të bëjë një veprimtari konkrete me nxënësit/et përmes këndimit dhe regjistrimit grafik të tingujve që ata/ato këndojnë. Për formën e parë mësuesi/ja zgjedh 2 ose 3 fragmente nga kënga "Festa e abetares" ku dallohet qartë koncepti muzikor. ***Ndalesa e parë dëgjimore:*** vihet CD me këngën "Festa e abetares" ku nxënësit/et duhet të dallojnë *gjatësinë e tingujve dhe theksin se* mbi cilën rrokje bie. ***Ndalesa e dytë dëgjimore:*** nxënësit/et duhet të dallojnë *lartësinë e tingujve* ku ngrihen dhe ulen tingujt, pra zëri? ***Ndalesa e tretë dëgjimore:*** nxënësit/et duhet të dallojnë *intensitetin e tingujve* ku forcohet dhe zbuten tingujt muzikorë, pra zëri?			

Forma e dytë Nxënësit/et dëgjojnë fragmentet muzikore dhe punojnë në grupe, për të shpjeguar karakteristikat e tingujve përmes simboleve të ndryshme grafike. Ata shpjegojnë regjistrimet grafike që bëjnë duke korrigjuar njëri-tjetrin.
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: Vetitë e tingujve; - diskutimin dhe mendimin në mënyrë të pavarur për tingujt e rregullt dhe përftimin e melodive përmes tyre; - krijimin e muzikës nëpërmjet modeleve që ai/ajo krijon vetë dhe me të tjerët.
Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE PËRMES ARTEVE TË TJERA

Informacion për mësuesin

Vetitë ose karakteristikat e tingullit janë:

1. Gjatësia- është mbajtja gjatë pa shkëputje e tingullit të zërit apo instrumentit dhe mbajtja shumë shkurt e tingullit të zërit apo instrumentit.
Refreni i këngës "Gjyshja dhe Petriti" ka tinguj të shkurtër dhe të gjatë. Pasi dëgjohet në magnetofon, veçohen këta tinguj, duke i kënduar ose i ligjëruar. Një paraqitje me grafik nga mësuesi në dërrasë, do të bënte që nxënësit/set të kuptonin më mirë tingujt *e shkurtër e të gjatë.*

Hapi I

Dëgjohet pjesa:

Ma -	cja	le	të	la -	het
1	2	1	1	1	2
(tinguj të shkurtër)				*(tinguj të gjatë)*	

pra -	më	do	të	tha -	het
1	2	1	1	1	2
(tinguj të shkurtër)				*(tinguj të gjatë)*	

Katër tingujt e parë ma – cja le- të janë të shkurtër, ndërsa la – het janë të gjatë.

2. Lartësia- është tingëllimi i lartë apo i ulët i zërit apo i instrumentit.

Hapi II

✇ - Dëgjohet refreni i këngës "Gabimi i Mirelës". Mësuesi dhe nxënësit, duke kënduar së bashku, gjejnë tingujt e ulët e të lartë. Në dërrasë të zezë mësuesi bën një grafik në ngjitje, duke vendosur fjalët mbi grafik për të treguar lartësinë e tingullit.



Grafikun mund ta ndërtoni me fije shkrepseje ose shkopinj të vegjël.
Pas regjistrimit grafik të refrenit, mësuesi/ja këndon duke shoqëruar sipas lartësisë së tingujve si dhe shpjegon ngritjen e zërit deri te fjala *kudo* si nota më e lartë. Kështu vazhdohet disa herë, për të fiksuar mirë tingujt e lartë ose të ulët të këngës.

3. Ngjyra- është këndimi apo luajtja, lehtë ose fortë i një tingulli nëpërmjet zërit ose instrumentit.

Hapi III

Vendoset kënga "Nina - nana" në magnetofon. Te kjo këngë dalin qartë ndryshimet në ngjyrimin e këngës. Ndryshimet demonstrohen nëpërmjet dëgjimit në Cd dhe më pas këndimit nga vetë nxënësit. Merrni mendimin e nxënësve se ku duhet të këndojnë lehtë apo fort. Kur të këndoni këngën, gjeni së bashku ato fraza ku tingujt këndohen lehtë ose fort.

Bëjuni pyetje nxënësve: Pse kjo këngë nuk mund të këndohet fort?

4. Timbri- ndryshimi i zërit të shokëve dhe shoqeve, ose i tingujve të instrumenteve.

Hapi IV

Nxirrni në mes të klasës një nxënës. I mbyllni sytë atij dhe kërkojini pas çdo zëri të gjejë, emrin e shoqes apo shokut të klasës.

Hapi V

✇Vendosen në magnetofon instrumente të ndryshme, si: piano, violina, zëra të ndryshëm të shokëve apo shoqeve etj.



<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Kënga “Fjalët magjike na pëlqejnë”</td><td colspan="2">Situata: Gjëegjëzë
Sjellja zbukuron njeriun
Kush sillet mirë nderon veten dhe familjen.
Përdorim fjalët magjike kurdo dhe kudo.

Vendosen disa fisha me fjalë të ndryshme. Nxënësit/et ndahen në 3 grupe dhe mundohen të krijojnë fjalitë e mësipërme. Pasi i kanë krijuar flasin për fjalët magjike.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore
Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngën duke iu përshtatur përmbajtjes së saj;
- shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon;
- këndon vetëm dhe në grup.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:

- melodia e këngës;
- teksti i këngës;
- rregullat e këndimit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- CD me melodinë e këngës;
- fotografi të ndryshme rreth festave;
- teksti i mësuesit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
- shkencat shoqërore dhe mjedisi: njohuri për shoqërinë;
- gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe;
- artet: arti pamor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Nxënësit/et përmendin tri festat që pëlqejnë më shumë, duke vendosur brenda tri pemëve me ngjyra të ndryshme (verdhë, kuqe, blu) dëshirat e tyre se si do të donin t’i festonin ato. Secili grup paraqet pemën e vet me mënyrën se si do të donin të festonin festa të ndryshme, si: ditëlindje, festën e Nënës, festën e Mësuesit, festën e Vitit të Ri etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Mësuesi/ja përmes situatës dhe pyetjeve që u bën nxënësve/eve u tërheq vëmendjen për festa të ndryshme që kanë festuar në klasë, shkollë, familje,komunitet etj. Më pas dëgjohet melodia e këngës në CD, mësohet teksti dhe melodia me fraza ose fjali. Nxënësit/et nxiten që të këndojnë të gjithë, ndërkohë që u kujtohet pozicioni dhe rregullat e këndimit. Kënga këndohet me dëshirë dhe ndjenjë dhe mund të shoqërohet me zilka. Nxënësit/et vizatojnë festën që u ka bërë më shumë përshtypje.</td></tr>
</table>

Vlerësimi
- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re (mësimi i këngës);
- këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- për bashkëpunimin dhe këndimin në grup të këngës.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

✇ **Dëgjohet** kënga "Fjalët magjike na pëlqejnë"dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:
- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Teksti dhe muzika:
Shpëtime Selimi Rrapushi

Fjalët magjike na pëlqejnë

I

Urdhëro, më fal,
Të gjitha jan' aty,
Janë fjal' që ngrejn' kala,
E të bëjnë njeri.

Refreni

Fjalët magjike si flutur fluturojn',
Nektar fëmijëve ato u dhurojn',
Të flasin bukur, të sillen mir',
Bëhen të ditur kalojn' fantazi.

II

Vjen dhe na troket,
Mes mendjeve m'i sjell,
Fjalët magjike,
Një ëndërr realitet.

Refreni

Fjalët magjike si flutur fluturojn'
etj.



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika që më pëlqen më shumë		**Situata: Shprehim emocionet** Nxënësit/et dëgjojnë në CD fragmente të ndryshme muzikore: këngë për fëmijë, muzikë nga filmat për fëmijë, muzikë popullore. Ata/ato lihen të lirë të shprehin emocionet përmes vizatimit, kërcimit, tregimit, poezisë etj.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon me vëmendje muzikën dhe përjeton emocionet që i jep ajo; - flet për muzikën e vet të parapëlqyer dhe shpjegon *pse*; - reflekton nëpërmjet arteve të tjera (*kërcim, ese, poezi vizatim*) emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj,.		**Fjalët kyçe:** - parapëlqim muzikor; - përjetim emocional.	
Burimet: - CD me shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - artet: kërcimi, arti pamor	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me dëgjimin në CD të fragmenteve të ndryshme muzikore: këngë për fëmijë, muzikë nga filmat për fëmijë, muzikë popullore. Nxënësit/et lihen të lirë të shprehin emocionet në forma të ndryshme, por kryesorja është përzgjedhja e këngëve që ata/ato pëlqejnë më shumë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja zhvillon më tej mësimin duke u kërkuar nxënësve/eve të shprehin dëshirën se si duan ta shpjegojnë muzikën që u pëlqen më shumë, pra se cilën formë pune do të ndjekin. Krijimi i një CD me këngët e parapëlqyera, është kërkesa kryesore, sepse i ndihmon edhe në përgatitjen e koncertit të fundvitit. Nxënësit/et ndahen në grupe dhe ndihmohen me ide gjatë punës së tyre. Të gjitha grupet krijojnë një CD me këngët e tyre më të parapëlqyer dhe shpjegojnë pse kanë përzgjedhur ato këngë. Nxënësit/et paraqesin CD-në e realizuar nga grupi ose në mënyrë individuale, duke bërë më pas vlerësimin e CD-së më të mirë, e cila do të jetë edhe CD për repertorin e koncertit të klasës. Ata/ato flasin duke argumentuar në mënyrë të thjeshtë rreth krijimit më të mirë, duke dhënë një gjykim të qartë dhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor. Muzika që dëgjojnë, dhe krijimet e tyre janë një formë e shprehjes emocionale.			

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- diskutimet qëai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: shprehja e emocioneve për muzikën që pëlqej më shumë.
- krijimin e punëve individuale ose në grup, nëpërmjet muzikës që dëgjon;
- qëndrimin apo gjykimin, teksa shprehet rreth krijimit më të mirë me fjalë të thjeshta dhe shpjegon pse e vlerëson dhe e pëlqen atë.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE PËRMES ARTEVE TË TJERA

Hapi I

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet që të kërcejnë sipas dëshirës muzikën e tyre të preferuar.**

Hapi II

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet që të vizatojnë ose të ngjyrosin një vizatim të gatshëm, sipas ndjesive që u jep muzika që dëgjojnë.**



PLANIFIKIMI TREMUJOR, LËNDA MUZIKË, PERIUDHA: PRILL-QERSHOR

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

1. aktivizohet në veprimtaritë muzikore/artistike;
2. kupton simbolet muzikore që i shfaqen;
3. shprehet në mënyrë të thjeshtë me anë të simboleve muzikore;
4. komunikon artistikisht në mënyrë të thjeshtë.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

1. **mendon në mënyrë krijuese;**
2. merr njohuritë në mënyrë të pavarur dhe krijuese;
3. zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese;
4. ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

Nxënësi/ja:

1. përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim muzikor;
2. përdor burime e gatshme për të realizuar një krijim muzikor;
3. zbaton detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

1. bëhet pjesë e nismave për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

1. zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive të ndryshme muzikore;
2. respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
3. bashkëpunon me të tjerët pavarësisht aftësive dhe nevojave.

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

1. diskuton me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

1. njeh mjetet e përdorimit në muzikë: magnetofon, kompjuter etj.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
• ***Krijimi muzikor***	• ***Interpretimi muzikor***	• ***Vlerësimi muzikor***
Nxënësi/ja: • kërkon dhe zbulon shumëllojshmëri burimesh ritmike dhe melodike (tingullore); • imiton dhe demonstron kuptimin e karakteristikave të tingujve muzikorë ose jo muzikorë; • improvizon modele të ndryshme ritmike ose jo ritmike; • demonstron zbatimin e elementeve të gjuhës muzikore, gjatë krijimeve të ndryshme; • komunikon njohuritë rreth gjuhës muzikore; • provon të improvizojë mbi një këngë apo melodi ritmin dhe karakterin duke përdorur elemente të tjera si trupin.	Nxënësi/ja: • interpreton gjatë këndimit, këngë dhe lojëra për fëmijë.; • demonstron gjatë luajtjes me mjetet trupore apo instrumentet fëmijërore me goditje se ka kuptuar elementet e ritmit dhe melodisë; • këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; • interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës; • interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; • interpreton lojërat muzikore duke ndihmuar në inskenimin e tyre; • respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera; • komunikon mendimin e vet rreth këngës apo lojës muzikore; • reflekton emocionet që i krijon një këngë, lojë muzikore apo pjesë muzikore gjatë interpretimit.	Nxënësi/ja: • shpreh qartë emocionet e veta ndaj muzikës; • jep mendimin e vet gjatë shpjegimit emocional të këngës, duke përdorur gjuhë të thjeshtë muzikore; • fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë muzikor për t'u shprehur në mënyrë artistike; • shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet e veta muzikore. • shpreh emocionet e veta për këngët apo lojërat muzikore që këndon; • përdor elemente të gjuhës muzikore gjatë shpjegimit emocional; • përjeton muzikën dhe përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; • bën lidhje ndërmjet asaj që përjeton dhe asaj që dëgjon nga një këngë, lojë muzikore apo fragment muzikor; • shpreh mendimin e vet rreth këngës/pjesës që dëgjon; • merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës; • përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar punën e vet dhe të të tjerëve; • ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

	NR.	TEMATIKA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT BURIMET
	1	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Tingulli *i lartë - i ulët, i fortë- i butë*	**Situata: Imitimi i kafshëve/ shpendëve/objekteve** Nxënësit/et të imitojnë zërat/tingujt që lëshojnë kafshë/shpendë apo objekte të ndryshme dhe i përshkruajnë ato me fjalë të ndryshme sipas fjalorit që kanë. Në dërrasë mund të vendosen fotografi të tyre dhe nxënësit/et të mundohen të imitojnë. - CD; - magnetofon; - fotografi; - teksti i mësuesit.
	2	*Teknika dhe procese*	Luajmë me instrumente me goditje	**Situata: Krijimi i modeleve ritmike me instrumente** Nxënësit/et marrin instrumentin e parapëlqyer dhe krijojnë modele ritmike. Modelet incizohen dhe një komision bën përzgjedhjen e modelit ritmik më të bukur. - CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	3	*Teknika dhe procese*	Rituale popullore	**Situata: Krijimi i një loje** Nxënësit/et improvizojnë një lojë duke vendosur si element: muzikën, fjalët dhe veprimet. Ata/ato shoqërojnë këngën lojë me instrumente me goditje. - CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit;
	4	*Teknika dhe procese*	Shoqërojmë ritualet me mjetet trupore	**Situata: Trupi në funksion të kënaqësisë muzikore** Nxënësve/eve u kërkohet të thonë ose të tregojnë pjesë të të trupit që shërbejnë në shoqërimin e këngëve të tyre të parapëlqyera. Ata/ato përdorin shuplakat apo këmbët për të shoqëruar këngë apo rituale të ndryshme muzikore të mësuara. Këngët mund t'i shoqërojnë sipas dëshirës. - teksti i mësuesit.

	5	*Teknika dhe procese*	Kënga“Tren, o tren”	**Situata: Unë dhe Shqipëria** Nxënësit/et gjenden në një situatë të këndshme muzikore, këndojnë dhe mbajnë ritmin. Ata/ato lidhen me njëri-tjetrin, duke formuar trenin dhe duke kënduar njëkohësisht. Kjo këngë u zhvillon atyre, ndjenjën ritmike dhe nëpërmjet tekstit u rritet ndjenja kombëtare. - CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	6	*Teknika dhe procese*	Kënga-lojë “Simfonia e kafshëve”	**Situata: Ne dhe natyra** Përmes disa fragmenteve muzikore nxënësit/et gjejnë emrat e kafshëve dhe të shpendëve që bëjnë pjesë në tekstin e këngës dhe flasin për kafshët ose shpendët e tyre të parapëlqyer. - CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	7	*Historia, muzika dhe shoqëria*	Muzika për fëmijë	**Situata: Vizatimi më i bukur përmes muzikës** Nxënësve/eve u kërkohet të shprehin emocionet ndaj muzikës për fëmijë që dëgjojnë përmes një vizatimi. Vizatimi më i bukur zgjidhet nga vetë ata/ato. Fituesi shpjegon pse zgjodhi të vizatojë atë emocion. - CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	8	*Gjuha dhe komunikimi muzikor*	Tingulli *i gjatë - i shkurtër*	**Situata: Gjiganti –shkurtabiqi** Nxënësit/et bëjnë lojën gjiganti - shkurtabiqi dhe krijojnë simbole grafike për kuptimin e konceptit në muzikë i gjatë – i shkurtër. Gjithashtu ata/ato dëgjojnë fragmente muzikore me tinguj të gjatë dhe të shkurtër për të kuptuar më mirë vetitë e tingullit. - CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.

	9	*Teknika dhe procese*	Kënga: "Unë dhe kominoshet "	**Situata: Veshja e përshtatshme** Nxënësit/et diskutojnë për veshjen: ***kur*** dhe ***si*** duhet të vishemi në mjedise dhe festa të caktuara. Ata/ato diskutojnë me njëri tjetrin. - CD; - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	10	*Teknika dhe procese*	Rikujtojmë këngët e mësuara	**Situata: Grupi më i mirë i këngëtarëve** Klasa ndahet në tri grupe, të cilat konkurrojnë për interpretimin më të mirë të këngëve të mësuara. Grupi më i mirë përzgjidhet nga vetë nxënësit/et. - CD - magnetofon; - teksti i mësuesit.
	11	*Teknika dhe procese*	Koncert	

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor

Tema mësimore: Tingulli i lartë - i ulët, i fortë- i butë</td><td colspan="2">Situata: Imitimi i kafshëve/ shpendëve/objekteve
Nxënësit/et imitojnë zërat/tingujt që lëshojnë kafshë/shpendë/ objekte të ndryshme dhe i përshkruajnë ato me fjalë të ndryshme sipas fjalorit të tyre. Në dërrasë mund të vendosen fotografi të tyre dhe ata/ato mundohen ti imitojnë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:
Nxënësi/ja:
- kupton se tingulli ka disa karakteristika (i lartë - i ulët, i fortë- i butë);
- përcakton karakteristikat e tingullit në mjedisin e vet;
- demonstron karakteristikat e tingullit, duke i imituar ato;
- gjen karakteristikat e tingullit tek objektet, kafshët, apo zërat njerëzorë;
- argumenton mendimin e vet, kur flet për karakteristikat e tingujve;
- respekton mendimin e të tjerëve.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
- tingull;
- i lartë;
- i ulët;
- i fortë;
- i butë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:

• CD me shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja;
• teksti i mësuesit;
• fotografi.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:

- gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe;
- shkencat e natyrës;
- artet: arti pamor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit/et imitojnë zërat/tingujt që lëshojnë kafshë/ shpendë apo objekte të ndryshme dhe i përshkruajnë ato me fjalë të ndryshme, sipas mendimit të tyre. Në dërrasë mund të vendosen edhe foto të tyre, të cilat ata/ato mundohen t’i imitojnë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Mësuesi/ja vendos fotografi të ndryshme dhe nxënësit/et nëpërmjet vëzhgimit që bëjnë kuptojnë se çfarë tingulli përftohet, i ulët “ i lartë; i fortë- i butë. Gjithashtu mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të kuptojnë burimin e tingullit dhe karakteristikat që mund të ketë ai tingull, krahasuar me një tjetër.
Mësuesi vendos në CD fragmente të shkurtra dhe të ndryshme të burimeve të tingujve dhe nxënësit/et i identifikojnë ato pasi i dëgjojnë.</td></tr>
</table>

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultateve e arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re: tingulli *i ulët " i lartë; i fortë- i butë*;
- diskutimin dhe mendimin në mënyrë të pavarur për shpejtësinë muzikore që dëgjon dhe pëlqen më shumë;
- shoqërimin e muzikës me lëvizje trupore vetëm ose në grup.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjet e tyre personale.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE

Hapi I

Nxënësve/eve u kërkohet të gjejnë se çfarë tingujsh lëshojnë objektet që shikojnë në figurë. Ata/ato shkruajnë me fjalë poshtë çdo figure që shikojnë karakteristikat e tingullit që objektet lëshojnë apo krijohet/prodhohet prej tyre.



Hapi II

✓ **Dëgjohen në CD burime tingujsh të ndryshëm, të cilët nxënësit/et i identifikojnë dhe i shkruajnë.**

1. i lartë

2._____

3._____

4._____

5. _____

6._____

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Luajmë me instrumente me goditje		**Situata: Krijimi i modeleve ritmike me instrumente** Nxënësit/et marrin instrumentin e parapëlqyer dhe krijojnë modele ritmike. Modelet incizohen dhe një komision bën përzgjedhjen e modelit ritmik më të bukur.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - improvizon ritme të thjeshta me instrumentet; - shoqëron me instrumente të thjeshta me goditje *ritme shumë thjeshta*; - shoqëron këngët me instrumente me goditje.		**Fjalët kyçe:** - instrumente me goditje; - tamburi; - zilka; - trekëndësh; - shkopinj.	
Burimet: - instrumente me goditje: *tambur, zilkë, trekëndësh, shkopinj etj.;* - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - artet: arti pamor; **Lidhja me temat ndërkurrikulare:** - identiteti ynë kombëtar (instrumentet popullore).	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësit/et marrin instrumentin e parapëlqyer dhe krijojnë një model ritmik. Modelet incizohen dhe një komision bën përzgjedhjen e modelit ritmik më të bukur.			
Ndërtimi i njohurive të reja Improvizimi i modeleve ritmike bëhet për të edukuar nxënësit/et me ritmin. Ata/ato i vizatojnë modelet e krijuara në dërrasë apo fletë sipas simboleve që duan apo u sugjeron mësuesi/ja. Më pas bëhet shoqërimi i këngëve të mësuara nga vetë nxënësit/et. Që të përfshihen të gjithë në shoqërimin e këngëve apo të ritualeve duhet të krijohen disa grupe. Gjithashtu nxënësit/et mund të këmbejnë instrumentet ndërmjet tyre, duke provuar kështu ndjesinë e shoqërimit me instrumente të ndryshme. Nxënësit/et: - ndahen në grupe për improvizimin ritmik të modeleve; - vizatojnë me simbole ritmin e krijuar nga vetë ata; - shoqërojnë në grupe këngë dhe rituale të ndryshme; - diskutojnë me njëri-tjetrin për emocionet që ndiejnë kur improvizojnë apo shoqërojnë me instrumente me goditje.			

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- shoqërimin e ritualit me instrumente me goditje në grup;
- ndjekjen e udhëzimeve gjatë shoqërimit me instrumente me goditje;
- shoqërimin e këngëve të tjera në grup me instrumentet me goditje të përgatitura nga vetë ai/ajo bashkë me të tjerët..

Detyrë: Incizimet, filmimet, fotografitë gjatë orës mësimore mund të ruhen si produkte në dosjen e nxënësit/es.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE

Hapi I

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet të luajnë modelin ritmik për instrumente me goditje.**



Pas realizimit të këtyre ushtrimeve nxënësit:
Do të krijojnë modele me ritme të thjeshta
Do të luajnë duke shoqëruar me instrumente ORF mbi modelet e krijuara
Do të shpjegojnë si i ndërtuan këto modele dhe pse.
Do të përshkruajnë ndjesinë që kanë pas realizmit të modeleve ritmike.

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Rituale ritmike</td><td colspan="2">Situata: Krijimi i modeleve ritmike me ritualet
Nxënësit/et recitojnë ritualin e parapëlqyer dhe krijojnë modele ritmike. Modelet incizohen dhe një komision bën përzgjedhjen e ritualit më të bukur.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:
Nxënësi/ja:
- improvizon ritme të thjeshta me instrumentet;
- shoqëron me instrumente të thjeshta me goditje ritualet;</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
- instrumente me goditje;
- tamburi;
- zilka;
- trekëndësh;
- shkopinj.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- instrumente me goditje: tambur, zilkë, trekëndësh, shkopinj etj.;
- teksti i mësuesit.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
- artet: arti pamor;
Lidhja me temat ndërkurrikulare:
- identiteti ynë kombëtar (rituale popullore).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Nxënësit/et recitojnë ritualin e parapëlqyer dhe krijojnë modele ritmike. Modelet incizohen dhe një komision bën përzgjedhjen e ritualit më të bukur.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Me ritualet popullore nxënësit/et njihen me folklorin popullor sipas krahinave të ndryshme. Më pas bëhet shoqërimi i ritualeve të mësuara nga vetë nxënësit/et. Që të përfshihen të gjithë në shoqërimin e ritualeve duhet të krijohen disa grupe. Gjithashtu nxënësit/et mund të këmbejnë instrumentet ndërmjet tyre, duke provuar kështu ndjesinë e shoqërimit me instrumente të ndryshme. Nxënësit/et:
- ndahen në grupe për improvizimin ritmik të modeleve;
- vizatojnë me simbole ritmin e krijuar nga vetë ata;
- shoqërojnë në grupe këngë dhe rituale të ndryshme;
- diskutojnë me njëri-tjetrin për emocionet që ndiejnë kur improvizojnë apo shoqërojnë me instrumente me goditje.</td></tr>
</table>

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *rezultatet e arritura* në:
- shoqërimin e ritualit me instrumente me goditje në grup;
- ndjekjen e udhëzimeve gjatë shoqërimit me instrumente me goditje;
- shoqërimin e këngëve të tjera në grup me instrumentet me goditje të përgatitura nga vetë ai/ajo bashkë me të tjerët..

Detyrë: Incizimet, filmimet, fotografitë gjatë orës mësimore mund të ruhen si produkte në dosjen e nxënësit/es.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE

Hapi I

✓ **Nxënësve/eve u kërkohet të luajnë modelin ritmik për instrumente me goditje që shikojnë (të shfaqur në ppt apo të shkruar në dërrasë të zezë), duke ndjekur udhëzimet si më poshtë:**



Pas realizimit të këtyre ushtrimeve nxënësit:
Do të krijojnë modele me ritme të thjeshta
Do të luajnë duke shoqëruar me instrumente ORF mbi modelet e krijuara
Do të shpjegojnë si i ndërtuan këto modele dhe pse.
Do të përshkruajnë ndjesinë që kanë pas realizmit të modeleve ritmike.

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Shoqërojmë ritualet me mjetet trupore</td><td colspan="2">Situata: Trupi në funksion të kënaqësisë muzikore
Nxënësve/eve u kërkohet të thonë pjesët e trupit dhe funksionin që ato kanë për të shërbyer në shoqërimin e këngëve që parapëlqejnë. Mund të tregohen pikërisht ato pjesë të trupit që ndihmojnë në shoqërimin e muzikës. Ata/ato përdorin shuplakat apo këmbët për të shoqëruar këngë apo rituale të ndryshme muzikore të mësuara dhe mund t’i shoqërojnë sipas dëshirës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore
Nxënësi/ja:
- improvizon ritme të thjeshta duke përdorur mjetet trupore (shuplakat, këmbët etj);
- imiton me fishkëllimë këngë të ndryshme për fëmijë;
- krijon modele ritmike shumë thjeshta dhe i paraqet ato nëpërmjet simboleve të thjeshta para klasës.</td><td colspan="2">Fjalë kyçe:
- lëvizje trupore: fishkëllimë, shuplaka, këmbët, rrahje mbi gjunjë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- teksti i mësuesit;
- materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja (foto).</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
- artet: arti pamor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Nxënësit/et thonë pjesët e trupit dhe funksionin që ata/ato kanë për të shërbyer në shoqërimin e këngëve të tyre të parapëlqyera. Më pas ata/ato përdorin shuplakat apo këmbët për të shoqëruar këngë apo rituale të ndryshme muzikore që kanë mësuar.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Improvizimi i modeleve ritmike, duke përdorur lëvizjet trupore, imitimi i melodive apo këngëve të parapëlqyera, krijimi i modeleve ritmike përmes vizatimit, pra paraqitjes me anë të simboleve bëhet për të forcuar më tej konceptin e ritmit muzikor te nxënësit/et. Modelet e krijuara nxënësit/et i vizatojnë në dërrasë apo fletë sipas simboleve që ata/ato duan apo të drejtuara nga mësuesi/ja.
Kjo gjë bëhet duke i ndarë nxënësit/et në grupe ku secili grup siaps detyrës së dhënë punojnë së bashku për t’ia arritur sa më mirë qëllimit. Ata/ato ndahen në grupe për:
- improvizimin ritmik të modeleve me shuplaka;
- imitimin me fishkëllimë të melodive të ndryshme;
- vizatimin me simbole ritmin e krijuar nga vetë ata/ato;
- shoqërimin në grupe të këngëve dhe të ritualeve të ndryshme;
Më pas ata/ato diskutojnë me njëri-tjetrin rreth punëve që ata/ato realizojnë.</td></tr>
</table>

Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura* në: - improvizimin ritmik të modeleve me shuplaka; - imitimin me fishkëllimë të melodive të ndryshme; - vizatimin me simbole të ritmit të krijuar nga vetë ata/ato; - shoqërimin në grupe të këngëve dhe ritualeve të ndryshme.
Detyrë: Incizimet, filmimet, fotot gjatë orës mësimore mund të ruhen si produkte në dosjen e nxënësit/es.

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

✓ **Nxënësit/et ndahen në grupe dhe u kërkohet:**



Grupi 1: të improvizojnë mbi modelet ritmike me shuplaka.

Grupi 2: të imitojnë me fishkëllimë të melodive të ndryshme.

Grupi 3: të vizatojnë me simbole ritmin e krijuar nga vetë ata.

Grupi 4: të shoqërojnë në grupe këngë dhe rituale të ndryshme.

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Kënga “Tren, o tren”</td><td colspan="2">Situata: Unë dhe Shqipëria
Nxënësit/et gjenden në një situatë të këndshme muzikore, këndojnë dhe mbajnë ritmin. Ata/ato lidhen me njëri-tjetrin, duke formuar trenin dhe duke kënduar njëkohësisht. Kjo këngë u zhvillon atyre, ndjenjën ritmike dhe nëpërmjet tekstit u rritet ndjenja kombëtare.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:
Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar teknikën dhe rregullat e këndimit;
- interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngës;
- interpreton këngët duke respektuar elementet e gjuhës muzikore.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
- melodia e këngës;
- teksti i këngës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- CD me melodinë e këngës;
- fisha me emrin e qyteteve, të parapërgatitura nga mësuesi/ja;
- teksti i mësuesit;
- instrumente me goditje.</td><td colspan="2">Lidhja me temat ndërkurrikulare:
- identiteti ynë kombëtar</td></tr>
<tr><th colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</th></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Mësim fillon me organizmin e nxënësve/eve për të imituar ritmin e trenit në lëvizje “çaf-çuf”. Në vijim ata/ato lëvizin sipas ritmit dhe njëkohësisht këndojnë.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Mësuesi/ja fillon t’u mësojë këngën: “Tren, o tren”, duke e mësuar atë varg pas vargu, strofë, dhe në fund duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Nxënësit/et duhet ta këndojnë me ndjenjë dhe emocion këngën, dhe në grup. Ata/ato:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth karakteristikave të kësaj kënge;
- këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi
- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:
- diskutimet ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).</td></tr>
<tr><td colspan="4">Detyrë: Punimet (vizatime të ndryshme) që nxënësit/et kanë bërë, ruhen në dosjen e tyre.</td></tr>
</table>

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga “Tren, o tren” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Tren, o tren

Tren, o tren i gjatë shum’
ndale vrapin të vij un’
të shëtisim Shqipërin’
që nga Shkodra der’ në Vlor’



Refreni

Këndon treni çaf e çuf,
jan’ vagonat shqipëtar’
O sa ndihemi krenar’
çan përpara pa u ndal’

Tren, o tren i bukur shum’
sa vjen dimri t’ mendoj un’
kur shikoj Shqipërin’
në një kopsht me trëndelina
rrëshqet treni nëpër shina
kënga jonë mori kthina.



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Këng-lojë "Simfonia e kafshëve"		**Situata: Ne dhe natyra** Përmes disa fragmenteve muzikore nxënësit/et gjejnë emrat e kafshëve dhe të shpendëve që bëjnë pjesë në tekstin e këngës dhe flasin për kafshët ose shpendët e tyre të parapëlqyer.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon duke respektuar teknikën dhe rregullat e këndimit; - interpreton këngë për fëmijë, duke iu përshtatur tematikës së këngës; - interpreton këngët duke respektuar elementet e gjuhës muzikore.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës.	
Burimet: - CD me melodinë e këngës; - materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit; - instrumente me goditje.		**Lidhja me temat ndërkurrikulare:** – biologjia, mjedisi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari - lojë, ku nxënësit/et dëgjojnë disa fragmenteve muzikore dhe gjejnë emrat e kafshëve dhe të shpendëve që bëjnë pjesë në tekstin e këngës dhe flasin për kafshët ose shpendët e tyre të parapëlqyer.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja fillon t'u mësojë këngën-lojë "Simfonia e kafshëve", duke e mësuar atë varg pas vargu, strofë, dhe në fund duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë, deri në përvetësimin e mirë të saj. Nxënësit/et duhet ta këndojnë me ndjenjë dhe emocion këngën, dhe në grup. Ata/ato: - diskutojnë mes tyre rreth karakteristikave të kafshëve në këngë; - këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.			
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura* në: - - diskutimet që ai /ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re; - - këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit; - - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).			
Detyrë: Punimet (vizatime të ndryshme) që nxënësit/et kanë bërë, ruhen në dosjen e tyre.			

HAPAT UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E ORËS MËSIMORE

Hapi I

Dëgjohet kënga-lojë "Simfonia e kafshëve" dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas hapave të mëposhtëm:

- këndohet kënga varg pas vargu;
- përsëriten vargjet herë pas here;
- këndohet strofa;
- këndohet strofa dhe refreni;
- përsëritet kënga nga fillimi në fund;
- interpretohet kënga me ndjenjë dhe emocion;
- këndohet kënga vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

Simfonia e kafshëve

1
Një zog' t'vogël un kam par',
Ta dëgjosh sa bukur k'ndonte
Ci-ci-ci bënte pa nda,
Ci-ci-ci dhe nuk pushonte.
Zogu ci-ci-ci-ci
Oh, sa bukuri!

2
Një qen t'vogël un' kam par',
Ta dëgjosh sa bukur bënte
Ham-ham-ham bënte… etj.

3
Një mic t'vogël un' kam par',
Ta dëgjosh sa bukur bënte
Miao-miao-miao bënte... etj.

4
Një qeng jt'vogël un' kam par',
Ta dëgjosh sa bukur bënte
Be-be-be bënte... etj.

5
Një gjel t'vogël un' kam par',
Ta dëgjosh sa bukur k'ndonte.
Ki- ki-ki bënte... etj.

Tish Daija



Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: *Historia, muzika dhe shoqëria* **Tema mësimore:** Muzika për fëmijë		**Situata: Vizatimi më i ndjerë përmes muzikës** Nxënësve/eve u kërkohet të shprehin përmes një vizatimi emocionet ndaj muzikës për fëmijë që ata/ato dëgjojnë. Vizatimi më i bukur zgjidhet nga vetë nxënësit/et. Fituesi/ja shpjegon pse zgjodhi të vizatojë atë emocion.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - dëgjon me vëmendje muzikën dhe përjeton emocionet që i jep ajo; - flet për muzikën e vet të parapëlqyer, duke shpjeguar *pse*; - reflekton emocionet që i krijon muzika gjatë dëgjimit të saj, nëpërmjet arteve të tjera: *kërcim, ese, poezi, vizatim*.		**Fjalët kyçe:** - parapëlqim muzikor; - përjetim emocional.	
Burimet: - CD me shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - artet: kërcimi, arti pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me dëgjimin nëpërmjet CD fragmente të ndryshme muzikore: këngë për fëmijë, muzikë nga filmat për fëmijë, muzikë popullore. Nxënësit/et lihen të lirë të shprehin emocionet përmes formave të ndryshme krijuese, por kryesorja është vizatimi. Vizatimi më i bukur zgjidhet nga vetë ata/ato. Fituesi/ja shpjegon pse zgjodhi të vizatojë atë emocion.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja zhvillon më tej mësimin, duke u kërkuar nxënësve/eve të shprehin dëshirën se si ata/ato duan të shpjegojnë muzikën që u pëlqen më shumë dhe formën e punës që duan të ndjekin. Përjetimi i emocioneve nga muzika që dëgjojnë dhe shprehja e tyre përmes vizatimit. Ata/ato ndahen në grupe dhe ndihmohen me ide gjatë punës së tyre; punojnë dhe shpjegojnë pse zgjodhën të vizatojnë atë tematikë. Nxënësit/et flasin duke argumentuar në mënyrë të thjeshtë rreth krijimit më të mirë duke dhënë një gjykim të qartë dhe duke përdorur një fjalor të thjeshtë muzikor. Muzika që dëgjojnë, dhe krijimet e tyre janë një formë e shprehjes emocionale.			

Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura* në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re mbi shprehjen e emocioneve për muzikën që pëlqen më shumë;
- krijimin e punëve individuale ose në grup, nëpërmjet muzikës së dëgjuar;
- qëndrimin apo gjykimin, duke u shprehur rreth krijimit më të mirë me fjalë të thjeshta, duke shpjeguar pse e vlerëson dhe e pëlqen atë.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjen e tyre personale.

VEPRIMTARI PËRMES ARTEVE TË TJERA

Hapi I

✓ ***Nxitini nxënësit/et të vizatojnë, sipas përjetimit emocional nga dëgjimi i pjesëve muzikore të vendosura në CD: këngë për fëmijë, muzikë filmash për fëmijë me tematika të tilla si:***

- *stinët e vitit;*
- *familja ime;*
- *natyrë e qetë;*
- *shoku/shoqja im/e;*
- *një peizazh.*

Hapi II

Duke dëgjuar pjesët muzikore nxitini nxënësit/et të shprehin me fjalë të thjeshta emocionet ndaj muzikës për fëmijë që dëgjojnë. Pse ata e pëlqejnë këtë muzikë?

Kjo muzikë më pëlqen, sepse…

Hapi III

Kjo muzikë NUK më pëlqen, sepse…

<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor

Tema mësimore: Tingulli i gjatë - i shkurtër</td><td colspan="2">Situata: Gjiganti –shkurtabiqi
Nxënësit/et bëjnë lojën e gjigantit dhe të shkurtabiqit dhe krijojnë simbole grafike për kuptimin e konceptit në muzikë i gjatë – i shkurtër.
Gjithashtu ata/ato dëgjojnë fragmente ku dëgjojnë tinguj të gjatë dhe të shkurtër për të kuptuar më mirë vetitë e tingullit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:
Nxënësi/ja:
- kupton se tingulli ka edhe një karakteristikë tjetër i gjatë – i shkurtër;
- demonstron të gjitha karakteristikat e tingullit që ka mësuar, duke i imituar ato;
- gjen të gjitha karakteristikat e tingujve tek objektet, kafshët, apo te zërat njerëzore;
- argumenton mendimin e vet, kur flet për karakteristikat e tingujve;
- respekton mendimin e të tjerëve.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
- tingull;
- i gjatë;
- i shkurtër.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
• CD me shembuj muzikorë të përgatitur nga mësuesi/ja;
• teksti i mësuesit;
• foto.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera:
• gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe;
• shkencat e natyrës;
• artet: arti pamor.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Mësimi fillon me një veprimtari ku nxënësit/et bëjnë lojën e gjigantit dhe shkurtabiqit dhe krijojnë simbole grafike për kuptimin e konceptit në muzikë i gjatë – i shkurtër. Gjithashtu ata/ato dëgjojnë fragmente muzikore (CD) ku dëgjojnë tinguj të gjatë dhe të shkurtër për të kuptuar më mirë vetitë e tingullit.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Nxënësi/ja:
- dëgjon CD me momente muzikore ose të shkëputura nga mjedisi ku dallon tingujt e gjatë dhe të shkurtër.;
- krijon imazhin e tingullit të shkurtër dhe të gjatë nëpërmjet materialeve të ricikluesshme ose vizatimit.
- demonstron se ka kuptuar konceptin e tingullit të gjatë dhe të shkurtër, ku pas çdo fotoje të paraqitur demonstron me veprime të ndryshme tingullin e gjatë dhe të shkurtër.
Mësuesi vendos në CD fragmente të shkurtra dhe të ndryshme të burimeve të tingujve dhe nxënësit/et i identifikojnë ato pasi i dëgjojnë.</td></tr>
</table>

Vlerësimi
- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura* në:
- kuptimin që ai/ajo zhvillon, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re: *tingujt e gjatë dhe të shkurtër*;
- krijimin e idesë së tingullit të gjatë dhe të shkurtër me mjete apo materiale të ndryshme rrethanore;
- diskutimin dhe argumentimin në mënyrë të pavarur mbi karakteristikat e tingujve.

Detyrë: Punët dhe detyrat e zhvilluara nga nxënësit/et, ruhen në dosjen e tyre personale.

VEPRIMTARI PRAKTIKE MUZIKORE

Hapi I

✓ **Nxënësit/es u kërkohet të identifikojnë tingujt *e gjatë dhe të shkurtër* përmes dëgjimit në CD të fragmenteve muzikore ose të shkëputura nga mjedisi.**

i gjatë

_____

_____

etj.

Hapi II

✓ ***Nxënësi/ja krijon imazhin* e tingullit të shkurtër dhe të gjatë nëpërmjet materialeve të ricikluesshme ose vizatimit.**

Hapi III

✓ ***Nxënësi/ja demonstron* se ka kuptuar konceptin e tingullit të gjatë dhe të shkurtër, teksa pas çdo fotoje të paraqitur demonstron me veprime të ndryshme tingullin e *gjatë dhe të shkurtër (me vizatim, me zë apo me imitim, nëpërmjet fjalëve të shkurtra apo të gjatë* që gjen etj.*).***





Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: I	Klasa: II
Tematika: Teknika dhe procese **Tema mësimore:** Kënga: "Unë dhe kominoshet"		**Situata: Veshja e përshtatshme** Nxënësit/et diskutojnë me njëri-tjetrin për veshjen, ***kur*** dhe ***si*** duhet ta veshim dhe përdorim atë në mjedise dhe festa të caktuara.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - këndon duke respektuar teknikën dhe rregullat e këndimit; - interpreton këngën duke iu përshtatur tematikës së këngës për fëmijë; - interpreton këngët duke respektuar elementet e gjuhës muzikore, *ritmin* dhe *intonacionin*.		**Fjalët kyçe:** - melodia e këngës; - teksti i këngës.	
Burimet: - CD me melodinë e këngës; - materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja; - teksti i mësuesit; - instrumente me goditje.		**Lidhja me fushat e tjera:** - gjuhët dhe komunikimi: gjuha shqipe; - shkencat shoqërore dhe mjedisi; - artet: arti pamor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një bisedë të nxitur nga disa fotografi që vendos mësuesi/ja. Nxënësit/et diskutojnë me njëri-tjetrin për veshjen, ***kur*** dhe ***si*** duhet ta veshim dhe përdorim atë në mjedise dhe festa të caktuara.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja fillon t'u mësojë nxënësve/eve këngën "Unë dhe kominoshet", duke e mësuar atë varg pas vargu, strofë dhe pastaj në fund duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata/ato: - këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe në intonacion; - këndojnë këngën me ndjenjë dhe emocion, dhe në grup.			
Vlerësimi - Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për *demonstrimin e rezultateve të arritura* në: - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re. - këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit. - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).			
Detyrë: Punimet (vizatime të ndryshme) që nxënësit/et kanë bërë, ruhen në dosjen e tyre.			

Hapat udhëzues për zhvillimin e orës mësimore

Hapi I

- **Vendoset** për dëgjim kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e këngës ”Unë dhe kominoshet ”sipas hapave të mëposhtëm:
  - këndimi varg pas vargu;
  - përsëritja e vargjeve herë pas here;
  - këndimi i strofës;
  - këndimi i strofës dhe i refrenit;
  - përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
  - interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
  - këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

Hapi II

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit e të interpretimit* të këngës.

Unë dhe kominoshet

Kominoshe pune babi më dhuroi,
t’bukra kominoshe,
ngjyrë kaltëroshe.
Porsi babi në pun’ dhe un’ do t’shkoj,
vesh me kominoshe,
ngjyrë kaltëroshe.

Refreni
Babi im është minator,
pistoletën mban në dor’,
un’ mësoj ai punon,
jetën ton’ e zbukurojm’.
Vesh me kominoshe.
ngjyrë kaltëroshe.



<table>
<tr><th>Fusha: Arte</th><th>Lënda: Muzikë</th><th>Shkalla: I</th><th>Klasa: II</th></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese

Tema mësimore: Rikujtojmë këngët e mësuara</td><td colspan="2">Situata: Grupi më i mirë i këngëtarëve
Klasa ndahet në tri grupe ku nxënësit/et konkurrojnë për interpretimin më të mirë të këngëve të mësuara. Grupi më i mirë përzgjidhet nga vetë ata/ato.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:
Nxënësi/ja:
- këndon duke respektuar rregullat e këndimit;
- interpreton këngë për fëmijë duke iu përshtatur tematikës së këngëve;
- interpreton këngët duke respektuar elementet e gjuhës muzikore në ritëm dhe intonacionin..</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:
- melodia e këngës;
- teksti i këngës.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet:
- CD me melodinë e këngës;
- materiale të parapërgatitura nga mësuesi/ja;
- teksti i mësuesit;
- instrumente me goditje.</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve
Klasa ndahet në tri grupe ku ata/ato shprehin mendimet e tyre rreth koncertit që duan të përgatisin. Nxënësit/et i përzgjedhin vetë këngët, poezitë, vallëzimet etj.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja
Mësuesi/ja orienton nxënësit/et rreth qëllimit që ata duan të realizojnë, duke u kërkuar të ndahen në grupe dhe të fillojnë të diskutojnë rreth repertorit që duan të sjellin nëpërmjet koncertit.
- Klasa ndahet në tri grupe ku secili shpreh mendimin e vet rreth koncertit që duan të përgatisin. Repertori më i pëlqyer fiton.
- Ata/ato përcaktojnë këngët, poezitë, vallëzimet etj.
- Të gjithë interpretojnë repertorin me ndjenjë dhe emocion.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Vlerësimi
- Vlerësimi i nxënësit/es do të bëhet për demonstrimin e rezultateve të arritura në:
- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin korrekt të këngëve në ritëm dhe intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (koncertit).</td></tr>
</table>

5. VLERËSIMI

5.1. Llojet e vlerësimit

Vlerësimi *për të nxënë* i nxënësit kryhet nëpërmjet: *vlerësimit të vazhduar, vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse dhe vlerësimit të portofolit të nxënësit.*

Vlerësimi *i të nxënit* të nxënësit kryhet nëpërmjet: vlerësimit periodik dhe vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi i vazhduar për të nxënët është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësve në të gjitha aspektet e të nxënit, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura. Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet e mësuesit me nxënësit, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj. Për vlerësimin e vazhduar, mësuesi përdor evidenca të arritjes së rezultateve të të nxënit, sipas niveleve të arritjes, për të mbledhur infomacione të dobishme për të nxënët e nxënësve.

Mësuesi është i lirë të përshtasë formatin e evidencës në varësi të specifikave të lëndës. Shënimet në evidencë mund të mbahen me notë, komente, fjalë etj. referuar niveleve të arritjes.

Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse ka për qëllim të mbledhë informacion për arritjet e nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni në përfundim të tremujorit. Testi/detyra përmbledhëse organizohet nga mësuesi i lëndës për të siguruar informacion nëse përparimi i nxënësve është në rrugën e duhur apo duhen ndërmarrë hapa për përmirësime të mundshme.

Vlerësimi me portofol ka për qëllim vëzhgimin dhe vlerësimin e nxënësit në një kontekst të gjerë, duke përfshirë dokumentimin e kontributeve dhe arritjeve të tij për fushën, lëndën, për kompetencat kyçe, për punën individuale dhe në grup, kreativitetin, talentin, si dhe për aspekte të gjykimit dhe reflektimit të nxënësit për veten dhe të tjerët. Portofoli përmban koleksion të organizuar të:

- punëve dhe detyrave të pavarura, të kryera në klasë dhe jashtë saj;
- projekteve individuale ose në grup;
- detyrave dhe kontributeve të krijuara nga nxënësit, të cilat janë përfaqësuese të talentit, të hulumtimeve praktike, të punëve tematike (me shkrim, audio-vizuale etj.);
- vetëvlerësimeve të nxënësit;
- vlerësimeve të prindërve.

5.2. Vlerësimi i nxënësit në klasat I - III

Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III bëhet me përshkrim. Ai përbëhet nga vlerësimi i vazhduar, vlerësimi i punimeve dhe i produkteve, si dhe vlerësimi i testimeve dhe detyrave të kontrollit.

Vlerësimi i nxënësit për arritjen e kompetencave të fushave të të nxënit realizohet me përshkrim në periudha periodike tremujore. Ai realizohet me *5 shkallë vlerësimi*[1] si më poshtë:

- *Shkalla 1*. "*Arritje të pakënaqshme*", kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënit.
- *Shkalla 2*. "*Arritje që kanë nevojë për përmirësim*", kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të të nxënit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e mësuesit.
- *Shkalla 3*. "*Arritje të kënaqshme*", kur nxënësi ka përmbushur kërkesat mesatare të të nxënit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë.
- *Shkalla 4*. "*Arritje shumë të kënaqshme*", kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të të nxënit.
- *Shkalla 5*. "*Arritje të shkëlqyera*", kur nxënësi përmbush plotësisht kërkesat e të nxënit të programit lëndor.

Vlerësimi kryhet sipas peshave në përqindje si më poshtë:

- Vlerësimi i vazhduar 45 %, i cili përmban përgatitjen e nxënësit dhe detyrave që bën në shtëpi (15%) si dhe punëve me shkrim që kryen nxënësi në klasë dhe përgjigjet që jep me gojë (30%).
- Vlerësimi i punimeve dhe i produkteve 25%, i cili përmban punën e pavarur, bashkëpunimin me nxënësit e tjerë, pjesëmarrjen në projekte dhe veprimtari të tjera që zhvillohen në klasë, si dhe nismat e tij individuale.
- Vlerësimi i rezultateve në testime dhe në detyra kontrolli 30%.

Në fund të vitit, pas realizimit të vlerësimit të tretë përshkrues, mësuesi përmbledh përparimin vjetor të nxënësit për kompetencat e fushave të të nxënit.

Vlerësimi përfundimtar i nxënësit për secilën lëndë, bëhet në fund të vitit shkollor.

[1] Kodet e shprehura me numra, nga 1 deri në 5 korrespondojnë me shkallët e vlerësimit përshkrues.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Shamku, Violeta
Muzika 2 : libër mësuesi / Violeta Shamku ; red.
Erina Çoku. – Tiranë : Pegi, 2016
100 f. ; 18.2x25.4 cm.
ISBN 978-9928-228-04-8

1.Muzika 2.Tekste për mësuesit 3.Tekste për shkollat
9-vjeçare

78 (072) (075.2)